




Koha

www.koha.mk



KOHA për enigma

FAQE 11-14

E përditshme informative Viti XI • Numri 3136 • E shtunë/e diel 29-30 korrik 2017 15 DEN



Të akuzuarit nuk pranojnë të dënohen për "terrorizëm"

Shkup, 28 korrik - Hyrja ilegale në Maqedoni, sasia dhe llojllojshmëria e arsenalit luftarak, veprat penale të kryera në Gushincë dhe Lagjen e Trimave, janë tregues të mjaftueshëm se 37 të akuzuarit nga grupi i "Kumanovës" kanë kryer vepra penale "terrorizëm" dhe "organizatë terroriste". Kështu tha prokurori publik Naum Panovski në

fjalët përfundimtare në procesin gjyqësor për "Lagjen e Trimave" të premtën para trupi gjyqësor, ku kërkoi që të akuzuarve t'ju shqiptohen dënime në bazë të normave dhe dispozitave ligjore. Ndërkohë, për vendimin dhe lartësinë e dënimeve, prokurori Panovski theksoi se fjalën e fundit duhet ta ketë trupi gjyqësor. "Në bazë të dëshmime verbale dhe materiale

që i kemi publikuar brenda këtij procesi gjyqësor, është vërtetuar se të akuzuarit janë kryerës të veprës penale për të cilën ngarkohen. Ndërkohë, deklaratat e dhëna nga të akuzuarit nuk janë përputhur, gjegjësisht të akuzuarit shpesh herë e kanë potencuar se mos implementimi i Marrëveshjes së Ohrit ka qenë shkak...

FAQE 5

Autoritetet shëndetësore thonë se s'ka vend për panikë

"Hantan" shkak për vdekjet në Simnicë



Virusi "Hantan", i cili transmetohet përmes minjve ka qenë shkak për vdekjen e babë e birë dhe infektimin e disa personave të tjerë nga Simnica e Gostivarit. Nga Ministria e Shëndetësisë sigurojnë se pacientët tjerë nga ky fshat që gjinden në Infektologji janë në gjendje të mirë, ndërsa në Simnicë dhe stane po bëhet deratizim i plotë dhe dezinfektim i të gjithë objekteve

FAQE 2

MERI KAVKALEVA

Kujt i pengon përkatësia ime kombëtare?



Manastir, 28 korrik - Çdo takim me shqiptaren ortodokse, profesoreshën e muzikës në Fakultetin pedagogjik në Manastir, pianisten e njohu Meri Kavkaleva - Stilkova, është edhe një provokim për të shkruar për këtë zonjë të vërtetë, e cila nuk ngushtohet kurrë të thotë se i takon kombit më të çiltër, kombit të Skënderbeut të madh.

FAQE 7

RAJON

Apostolova fajëson Mitrovicën e Veriut

FAQE 16

GLOBI

Senati amerikan, sanksione ndaj Moskës

FAQE 17





Autoritetet shëndetësore thonë se s'ka vend për panikë

Virusi "Hantan" shkak për vdekjet në Simnicë

Virusi "Hantan", i cili transmetohet përmes minjve ka qenë shkak për vdekjen e babë e birë dhe infektimin e disa personave të tjerë nga Simnica e Gostivarit. Nga Ministria e Shëndetësisë sigurojnë se pacientët tjerë nga ky fshat që gjinden në Infektologji janë në gjendje të mirë, ndërsa në Simnicë dhe stane po bëhet deratizim i plotë dhe dezinfektim i të gjithë objekteve

Koha | Omer XHAFERI

Shkup, 28 korrik - Shtatë pacientët nga fshati Simnicë i Gostivarit, të hospitalizuar në Klinikën për sëmundje infektuese janë në gjendje të mirë dhe priten rezultatet e tyre nga laboratorit ynë dhe nga qendrat referente, deklaroi të premten zëvendësministri i Shëndetësisë Goce Çakarovski. Rezultatet nga analiza për konfirmim të arsyes për vdekjen e dy personave nga fshati Simnicë i Gostivarit të cilët ndëruan jetë në Klinikën për sëmundje infektuese pasi janë sjellë në gjendje të rëndë shëndetësore, kanë treguar se ata kanë qenë pozitiv të virusit Hantan, i cili nuk transmetohet nga njeriu në njeri. Çakarovski tha se në këtë moment në fshat dhe stan po bëhet deratizim i plotë dhe dezinfektim i të gjithë objekteve në fshat dhe rrethinë. Ai potencoi se priten rezultate nga mostrat nga uji dhe rezultatet nga Agjencia për



ushqim dhe veterinari. "Nuk ka vend për panik, gjithçka është nën kontroll", potencoi Çakarovski. Ai tha se po ndërmarin gjithçka që është në ingerencë të Ministrisë. "Ky virus transmetohet përmes minjve. Se si saktë është paraqitur sapo të kuptojmë do ta informojmë edhe opinionin. Komisioni për sëmundje infektuese vazhdimisht mblidhet dhe janë përfshirë të gjithë institucionet. Dje e vizituam edhe repartin infektues në Gostivar, ofruam ndihmë, atje nuk kishte pacientë të rinj. Sot nuk ka pacientë të rinj", shtoi Çakarovski duke iu përgjigjur pyetjes së gazetarëve pas konferencës për shtyp me rastin e shënimit të Ditës botërore për luftë kundër hepatitit. Paraprakisht, ministri i Shëndetësisë Arben Taravari në një postim në rrjetin social Facebook

paraprakisht ka thënë se Ministria e Shëndetësisë dhe Komisioni për sëmundje ngjitëse edhe gjatë ditës së premte i ndoqi ngjarjet të lidhura me dy rastet fatale të pacientëve me formë të rëndë akute progreduese të sëmundjes febrile me përfshirje multiorganike. "Gjatë ditës së djeshme, ekupe profesionale të Institutit të Shëndetit Publik dhe Qendrës për shëndet publik-Tetovë, dolën në terren në fsh. Simnicë, ku kryen ekspertizë dhe anketë epidemiologjike, me cka është bërë deratizimi dhe dezinfektimi i shtëpive dhe objekteve të të ndjerëve, janë marrë mostra për analizë për ujin e pijshëm, është bërë edukim shëndetësor të popullatës për simptomat dhe prevenimin e sëmundjes", ka thënë ministri Taravari. Gjatë ditës së premte, ka shtuar ai, ekipet profe-

sionale përgjegjës së bashku me Agjencionin për ushqim dhe veterinari, i zgjeruan mbikëqyrjet e rrethit më të gjerë, duke përfshirë vathën ku kanë qëndruar disa nga të prekurit. "Ekipi i Ministrisë së Shëndetësisë me përfaqësues të Klinikës infektive, e vizituan repartin infektiv pranë Spitalit të përgjithshëm Gostivar, gjatë së cilës kryen konsultime metodologjiko-profesionale me personelin mjekësor. Posa morëm rezultatet e analizave për dy të ndjerët, përmes së cilave me teknika të larta sensitive është vërtetuar shkaktari etiologjik – virusi Hantan, shkaktar më i shpeshtë i etheve akute hemorragjike me sindrom renal në këtë rajon. Ju informojmë se kjo sëmundje nuk transmetohet nga njeriu në njeri. Ministria e shëndetësisë edhe më tutje e nd-

jek me vigjencë situatën", thuhet më tej në reagimin e tij. Ndërkaq, Lëvizja BESA-Gostivar ka kërkuar përgjegjësi dhe raport të detajuar nga institucionet përkatëse rastin. "Rrethanat që quan në humbjen e jetës së dy anëtarëve të kësaj familje, prindit dhe të birit, na çojnë që përtej dhembjes të shprehim edhe shqetësimin me organet kompetente. Për më tepër, janë të dyshimta dhe kontradiktore edhe informatat e organeve zyrtare të cilat e bëjnë akoma më të dyshimtë dhe më të ndjeshëm këtë rast tragjik", thuhet në kumtesën nga Lëvizja BESA. Lëvizja BESA dega në Gostivar kërkon përgjegjësi dhe raport të detajuar nga institucionet përkatëse. "Gjykojmë se nuk është aspak serioze që i tërë rasti të përkufizohet me dy – tre fjali që ministri i Shëndetësisë i tha përmes një videoje në rrjetin e tij social nga SHBA-ja derisa dy bashkëqytetarë tanë e humbën jetën, ndërsa të tjerë vazhdojnë të hospitalizohen nga kjo sëmundje e pasqaruar deri më tani", thuhet në kumtesën e Lëvizjes BESA, ku shprehen ngushëllimet më të sinqerta dhe bashkëndjenjë me familjen Miftari nga fshati Simnicë, të cilët humbën dy anëtarë të familjes brenda dy ditëve. VMRO nga ana tjetër ditë më parë ka kërkuar dorëheqjen e ministrit Taravari për shkak të situatës së krijuar rreth virusit në Simnicë, ndërsa akuzoi Qeverinë për paafësi. Por LSDM është kundërpërgjigjur se VMRO-

DPMNE përmes ministrit të saj Nikolla Todorov e ka shkatërruar sistemin shëndetësor dhe ka shkelur mbi dinjitetin e mjekëve dhe pacientëve. Të udhehequr nga interese biznesore korruptive dhe tendera kriminal, VMRO-DPMNE dhe Todorov sistemin shëndetësor të Maqedonisë e kanë shndërruar në sistemin më të keq dhe më vdekjeprurës në Evropë, shprehet në kumtesë LSDM-ja. "Me dinakërinë dhe paftyresinë që po e bën opozitën VMRO-DPMNE-ja në mungesë të ideve, e shfrytëzon fatkeqësinë e qytetarëve dhe në mënyrë qyqare tenton të fitojë ndonjë poen politik. Politikat kriminale të VMRO-DPMNE-së pas vetes kanë lënë një sistem të shkatërruar shëndetësor, mungesë të aparaturës moderne dhe të kuadrit mjekësor, spitale dhe shtëpi shëndeti duke u rrënuar, kjo tregohet edhe në këtë rast ku për shkak të borxheve dhe llogarive të bllokua Instituti për shëndet publik ka mbetur pa reagjencë dhe ata duhet ti huazojnë nga shtetet fqinje. Insitucionet kompetente po punojnë në trajtimin e sëmundjes, po ndërmerren të gjitha masat për preventivë dhe ndalim të përsëritjes dhe të shpërndarjes së virusit. Institucionet në mënyrë aktive po punojnë në funksion të zgjidhjes së masë të shpejtë dhe efikase të problemeve të trashëguara nga VMRO-DPMNE dhe përmirësimin e kushteve jetësore për të gjithë qytetarët", shprehet në kumtesë LSDM-ja.

Stërvitja "Dragoon Guardian 17" në Krivollak

300 ushtarët amerikanë arritën në Maqedoni

Kriva Pallankë, 28 korrik - Në gjashtë karvane me nga 20 automjete ushtarake të premten përmes vendkalimit "Deve Bair" nga Bullgaria në Maqedoni arritën 300 pjesëtarë të Forcave të armatosura të SHBA-së, të cilët do të marrin pjesë në stërvitjen e përbashkët me inxhinierët e Armatës së Republikës së Maqedonisë "DRAGOON GUARDIAN 17". Në Kumanovë është mbajtur pjesa zyrtare e fillimit të stërvitjes e cila do të zhvillohet në Poligonin e armatës "Krivollak" si dhe në disa qytete në Maqedoni do të prezantohen pjesë të automjeteve ushtarake të Forcave të armatosura të SHBA-së. Mw pas, në kuadër të



bashkëpunimit civil-ushtarak, automjetet do të prezantohen në Shkup, Shtip dhe Veles, me ç'rast

përmes interaksionit me popullatën lokale, krahas prezantimit do të realizohen fitnes sesione dhe

gara për fëmijë. Më 31 korrik në Krivollak do të mbahet Ditë e hapur për mysafirë të lartë dhe medi-

ume. Më 3 dhe 4 gusht vazhdojnë aktivitetet me bashkëpunim civil ushtarak në Strumicë dhe Strugë ku krahas prezantimit të pajisjes do të mbahet edhe ndeshje futbollit ndërmjet pjesëtarëve të të dy armatave me klubin lokal. Në poligonin "Krivollak" kanë filluar edhe aktivitetet e përbashkëta të dy armatave, ku ARM me 95 pjesëtarë do ta tregojë gatishmërinë në përgjigje të skenarit të përgatitur për stërvitje. Aktiviteti i parë do të jetë përpunimi i Rrugicës fluturuese-ateruese (RRFA) për fluturake pa pilot në gjatësi prej 300 dhe gjerësi 30 metra. RRFA do të përpunohet sipas të gjitha standardëve të ushtrisë amerikane,

ndërkaq do t'i mbetet për shfrytëzim ARM-së. Gjatë stërvitjes, inxhinierët do të pastrojnë rrugët nga mjetet e improvizuara shpërthyes, ndërsa njësitë ABHO do të stërvisin mbrojtje nga armë automatike dhe mënyrën e dekontaminimit. Aktiviteti i fundit do të jetë njohja me armatimet personale të të dy armatave me ç'rast do të kryhen edhe qitje ushtarake. Stërvitja dedikohet për mbështetje të caqeve për trajnim për përforsim të procedurave operative standarde të njësisë inxhinierike dhe ABHO nga përbërja e ARM-së, si dhe avancim i mirëkuptimit të ndërsjellë mes ARM-së dhe FA të SHBA-së.



Me organizimin e zgjedhjeve lokale sipas standardeve ndërkombëtare kurorëzohet pjesa e parë e Planit 3-6-9, por mbarëvajtja e procesit zgjedhor është edhe përcaktues për procesin eurointegruer, tha zëvendëskryeministri Bujar Osmani

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 28 korrik - Zgjedhjet e ardhshme lokale shënojnë fundin e fazës së parë e cila duhet të sjellë vlerësim të rëndësishëm nëse me të vërtetë i jemi kthyer procesit eurointegruer dhe në përgjithësi rrugës demokratike. Nga këtu, zgjedhjet lokale, të cilat pasojnë janë kurorë e pjesës 3 nga Plani 3-6-9, deklaroi zëvendëskryeministri për eurointegrim Bujar Osmani të premtën në tribunën kushtuar "Implementimit të masave nga Plani 3-6-9 në pjesën e zgjedhjeve". "Zgjedhje kredibile dhe të lira janë përcaktim i rëndësishëm në bazë të së cilës do të vlerësohemi nga partnerët ndërkombëtar. Megjithatë, ajo që është më e rëndësishme, e drejta e votës, shprehja e lirë e votës, konkurrencë korrekte politike dhe rezultate të besueshme nga zgjedhjet janë parakusht themelor për demokraci reprezentuese ndaj të cilës të gjithë synojmë", tha Osmani. Ministri i Punëve të Brendshme Oliver Spasovski tha se MPB-ja në bashkëpunim me KSHZ-në vazhdimisht punojnë në përmirësimin e Listës zgjedhore dhe në pajtueshmëri me përvojat nga zgjedhje paraprake parlamentare, janë të fokusuar në dy gjëra - kredibiliteti i listës zgjedhore të jetë në nivel më të lartë, dhe organizimi i zgjedhjeve të sigurt, korrekte dhe demokra-

Osmani prezanton Planin 3-6-9 për zgjedhjet

Me zgjedhjet lokale përmbillet pjesa e parë



tike, që qytetarët të mundën në mënyrë të pavarur të vendosin. "Me rëndësi të jashtëzakonshme është se sa secili nga institucionet, secili nga bartësit e pozicioneve do të kontribuojnë që të kemi zgjedhje korrekte, demokratike dhe të lira. Këtë ne duhet ta mundësojmë dhe të jetë prioriteti i lartë i të gjithë neve si institucione. Sipas kësaj do

të na vlerësojnë edhe në BE, por për neve janë të rëndësishme vlerat demokratike dhe evropiane të jenë mënyrë e funksionimit të institucioneve në RM. Në këtë kuptim konsideroj se secili nga ne duhet të bëjë gjithçka që t'i lëmë qytetarët e RM-së të sjellin vendim të vërtetë, gjegjësisht të zgjedhin pushtet lokal siç meritojnë ose

çfarë dëshirojnë të kenë në bazë të parimeve kryesore demokratike", tha Spasovski. Kryetari i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve Aleksandar Çiçakovski, theksoi se KSHZ-ja është e gatshme për zgjedhjet e ardhshme lokale dhe se përgatitjet për mbajtjen e tyre kanë filluar menjëherë pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në

dhjetor të vitit 2016. Masat e ndërmarrja, shtoi, janë në pajtueshmëri me masat nga Plani 3-6-9 të Qeverisë të cilat janë sjellë në proces inkluziv përmes konsultimit të më shumë institucioneve relevante, duke e përfshirë edhe KSHZ-në. Theksoi, mes tjerash, se analizat e realizuar kanë treguar se prioritetet kyçe në këtë periudhë duhet t'i kenë përmirësimin e organizimit të brendshëm, efikasitetin dhe transparencën në punën e KSHZ-së, pengimin e të gjithë mundësive për ndikime politike në miratimin e vendimeve si në kuadër të KSHZ-së, ashtu edhe në kuadër të komisioneve zgjedhore komunale dhe këshillave zgjedhorë, miratim të akteve nënligjore për rregullim të më shumë procedurave zgjedhore, avancim të edukimit të KZK dhe KZ me qëllim të përmirësimit të performancave të tyre të punës sepse aktorë kryesor në zbatimin e zgjedhjeve lokale do të jenë para së gjithash KZK-të, tha Çiçakovski. Konfirmoi se aktivitetet kyçe të KSHZ-së ka qenë edhe rritja e azhurnimit dhe saktësia e listës zgjedhore për çka, thotë, ndihmë e madhe do të kenë edhe faktin që ndërkohe organizuan dhe zbatuan disa referendume lokale. "KSHZ për momentin po përfundon me ndër-marrjen e aktiviteteve dhe masave të cilat u planifikuan për përgatitje të

zgjedhjeve lokale dhe të përgatitjes e presim aktin për shpallje të zgjedhjeve lokale nga ana e kryetarit të Kuvendit të RM-së. Me aktivitetet të cilat ndërkohe i ndërmorëm adresohen një pjesë më e madhe e rekomandimeve të cilat janë theksuar në raportin e fundit të OSBE/ODIHR në pjesën e masave për të cilat ishin të nevojshme ndryshime ligjore. Me këto aktivitete në pjesën më të madhe realizohen edhe masa të parapara në Planin 3-6-9 në pjesën e zgjedhjeve", tha Çiçakovski. Në pyetjen e gazetarëve, Çiçakovski theksoi se shkalla e saktësisë së listës zgjedhore varet nga shkalla e saktësisë dhe azhurnimit të së dhënave të cilat i marrin nga institucionet relevante, e jo vetëm nga MPB-ja dhe se bëhet fjalë për proces dinamik. Pas zbatimit të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare është punuar në tejkalimin e problemeve sistematike me qëllim të bashkëpunimit më të afërt me të gjithë institucionet kompetente. KSHZ-ja, shtoi, një vit e përdor edhe sistemin VIMS me të cilin verifikohet integriteti i të dhënave të cilat i marrin nga institucionet relevante dhe i cili në kontinuitet do ta mundësojë ndjekjen e tyre. Sipas Spasovskit, vërejtja kyçe në pjesën e pastrimit të listës zgjedhore ka qenë lidhur me mënyrën e dhënies të letërnjoftimeve. "Më e rëndësishme nga gjithçka janë lëshimet të cilat janë bërë në të kaluarën gjatë dhënies së dokumenteve të mënjanoher. Ato janë mënjanoher por do të duhet të kërkohet edhe ndonjë zgjidhje sistematike të lidhjes së institucioneve dhe të sistemeve të tyre në menaxhim me këto dokumente me qëllim që të mënjanoher mundësia ose varësia nga ato kush udhëheq me cilindo nga organet", tha ministri Spasovski.

Zhbgar: Shkupi dhe Sofja japin shembull si të zgjidhen problemet

Marrëveshja për fqinjësi të mirë me Bullgarinë është shembull si dy shtete mundën vetë të zgjidhin një problem i cili ka ekzistuar shumë vite, deklaroi shefi i Delegacionit të BE-së në Maqedoni ambasadori i BE-së Samuel Zhbgar. "Unë duhet ta përhëndes këtë marrëveshje, sepse mendoj se është marrëveshje e cili do t'i ndryshojë marrëdhëniet jo vetëm mes dy vendeve, por edhe në rajon. Ky është shembull si dy shtete mund ta zgjidhin problemin i cili ka ekzistuar me vite, dhe si mund ta hapin rrugën e bashkëpunimit për të ardhmen", thotë ambasadori Zhbgar në një intervistë për TV 21. Sipas tij, marrëveshja do të sjell ndryshime të cilat njerëzit duhet t'i shohin. Lidhur me Planin qeveritar "3-6-9" euroambasadori Zhbgar theksoi se ky është vetëm hap fillestar deri te realiteti i ri në shtet. Ai theksoi se në BE dhe vendet anëtare ekziston optimizëm për perspektivat e vendeve lidhur me eurointegrimet.

Takohen partitë nënshkruese të Deklaratës

Për shkak të gjuhës edhe PDSH braktis tryezën

Për shkak të dallimeve rreth Ligjit për shqipen PDSH ka braktisur takimin, ndërsa nikoqiri Gëzim Ostreni tha gjuha do të miratohet në Parlament pavarësisht se kur e jep mendimin Komisioni i Venecias



Shkup, 28 korrik - Partia Demokratike Shqiptare të premtën ka braktisur takimin e liderëve të partive shqiptare. Shkak për këtë, siç tha Bekim Fazliu nga kjo parti, është propozimi i partive shqiptare në pushtet për Ligjin e gjuhëve, i cili sipas tij, është vetëm një mashtrim i radhës siç ka ndodhur edhe herave tjera. "E lëshuam tryezën për shkak të qasjes jo-ko-

rrekte të partive që janë pjesë e qeverisë dhe pjesëmarrëseve në tryezë. Kemi dallime të mëdha sa i përket zyrtarizmit të gjuhës shqipe, vlerësojmë se propozimi i tyre është mashtrim. I njëjti

mashttrim dhe propozim siç është bërë në 2008-tën dhe 2011-tën, nuk zgjidh asgjë", tha Bekim Fazliu nga PDSH në Parlament, ku edhe u mbajt takimi radhës i përfaqësuesve të partive politike shqiptare

për të diskutuar mbi zbatimin e deritashëm të Deklaratës së partive politike shqiptare. Ai më tej theksoi se PDSH u ka dorëzuar më herët partive shqiptare propozimet e saj për gjuhën shqipe, të

bazuar në siç tha ai, praktikant më të mira të shteteve evropiane dhe atyre rajonale. "Ne si PDSH ua dorëzuam partive tjera propozimin për gjuhën shqipe, që është bazuar në praktikant më të mira dhe moderne evropiane, perëndimore dhe në rajon, nga vende multi-etnike Kanada, Finlanda, Bosnja, Kosova. Vlerësojmë se ky është një mashtrim i radhës për gjuhën shqipe", tha Fazliu. Sipas asaj që tha nikoqiri i takimit Gëzim Ostreni, në takim kanë diskutuar vetëm për Ligjin për gjuhën shqipe e jo edhe për pika të tjera të Deklaratës shqiptare, të cilat siç tha, do të diskutohen në takimet tjera dhe do të marrin mendim nga ekspertët. "Ashti siç e dini edhe ju, Ligji do të përgatitet në Qeveri dhe nga

ministra përkatës dhe më pas do të diskutohet edhe këtu në Parlament. Ligji do të shkojë edhe në Komisionin e Venedikut, por kjo nuk do të pengojë që ligji të silltet më parë dhe më pas të merret mendim nga ky Komision", theksoi pas takimit kreu u Unitetit, Gëzim Ostreni. Në takimin që u thirr nga ai nga BDI mori pjesë lideri i saj Ali Ahmeti bashkë me nënkryetarin Izet Mexhti dhe deputeti Artan Grubi, nga LR-PDSH mori pjesë deputeti Syrja Rushiti, nga RDK kryetari i saj Vesel Memedi, ndërsa nga PDSH Bekim Fazliu, i cili edhe e braktisi takimin. Lëvizja BESA sërish bojkotoi këtë takim, i cili është edhe i katërti më radhë mes përfaqësuesve të partive shqiptare. (F.R)



Një nga zgjidhjet e problemeve me tepicën e të punësuarve në administratë, është që ai që ndjehet i aftë, t'i ofrohen paga për 24 muaj, me qëllim që të kalojë në sektorin privat

Afaristët thonë se një pjesë e administratës, që do të ndihmohen të hapin biznese të reja, apo profilet e caktuara që ju mungojnë kompanive private dhe që punojnë në punë të shtetit, edhe mund të ndryshojnë vendin e punës

Kalimi i administratës në sektorin privat

Pa imponim, por sipas nevojave reale

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 28 korrik - Ideja e qeverisë që të sigurojë rroga më të larta, për ata që do të kalojnë të punojnë nga administrata publike në sektorin privat, në praktikë mund të realizohet, por vetëm në bazë të nevojave reale të biznesit për profilet të caktuara të punëtorëve dhe pa imponime. Afaristët thonë se një pjesë e administratës, që do të ndihmohen të hapin biznese të reja, apo profilet e caktuara që ju mungojnë kompanive private dhe që punojnë në punë të shtetit, edhe mund të ndryshojnë vendin e punës.

Në ndërkohë, shteti pritet të ndihmojë edhe financiarisht firmat që do të punësojnë persona nga sektori publik, me qëllim që të sigurohet administratë efikase që do t'i përgjigjet nevojave të ekonomisë dhe qytetarëve. Ideja e qeverisë është që të sigurojë rroga më të larta përmes subvencioneve për ata që do të kalojnë të punojnë nga administrata publike në sektorin privat. Mbështetja financiare shtetërore parashikohet që të jetë përmes mbulimit në vitin e parë të pagës nga ana e shtetit, por me kusht që personi të qëndrojë në punë në kompaninë private për së paku edhe një vit. Në këtë mënyrë synohet që krahas rritjes së pagave të ulet edhe numri i të punësuarve në administratën publike. Përfaqësuesit e biznesit kanë mendime të ndara lidhur me transferin e një pjese të administratës në kompanitë private. Nga njëra anë, ka mendime se kuadri nga sektori publik nuk është një profil i duhur për biznesin, e aq më pak se administrata do të pajtohet të ndryshojë vendin e punës me privilegje të shumta. Ka edhe vlerësime të tilla se kjo ide edhe mund të realizohet, por vetëm në bazë të nevojave reale të biznesit për kuadër dhe jo me imponime. Sipas afaristit, Menderez Kuçi, me siguri se një pjesë e caktuar e administratës publike, por edhe e të punësuarve në kompanitë e mëdha



publike mund të gjejnë vendin e ri të punës në sektorin privat.

"Ekziston hapësirë që në bazë të nevojave të kompanive private për profilet të caktuara të profesionistëve me përvojë më të madhe pune, që ato të kalojnë të punojnë nga administrata në sektorin privat, por vetëm me kusht që një gjë e tillë të realizohet në bazë të nevojave reale të biznesit dhe jo me imponim. Me fjalë të tjera, ka mundësi që një pjesë e administratës që janë një apo dy vite para pensionit që të kalojnë të punojnë në kompanitë private, duke sjellë kështu përfitim për pronarët e bizneseve, me kompetencat dhe shkathhtësitë e tyre në vendin e ri të punës", thekson Kuçi. Sipas tij, në këtë drejtim nevojitet të gjendet një balanc ndërmjet asaj se çka ofron teprica e administratës si dhe nevojave të vërteta të sektorit privat. Në ndërkohë, pjesa tjetër e biznesit vlerëson se një pjesë e caktuar e të punësuarve në administratë vështirë se do të pajtohet të ndryshojë vendin e punës, ku ka privilegje të shumta.

"Vështirë se dikush do të heqë dorë nga administrata, bile edhe me shpërbllimin të

pagës më të lartë në sektorin privat. Te ne kjo është çështje e vetëdijes, gjegjësisht të bindjes së pranuar nga të gjithë se puna e shtetit sjell siguri dhe mbrojtje më të madhe në raport me punën në kompanitë private", thotë kryetari i Organizatës së Punëdhënësve të Maqedonisë, Angel Dimitrov.

Në ndërkohë, afaristët e tjerë, thonë se nevojitet të stimulohen të rinjtë të punësuar në administratë që kanë ide dhe motiv për të hapur biznese të reja që të kalojnë në ujërat e sipërmarrjes, duke u larguar nga puna e shtetit.

"Nëse dikush është i kënaqur që tërë jetën të jetë ndihmës i ri, atëherë as me bager nuk mund ta detyroni që të ikë. Ai do të mbesë në administratë me ato ambicie dhe shprehje pune që i ka, por nga ana tjetër besoj se në administratë ekzistojnë njerëz të rinj që ju fle sipërmarrja në shpirt dhe që dëshirojnë të bëjnë diçka më shumë në jetë dhe personat e tillë kësaj oferte do t'i përgjigjeshin pozitivisht", thotë afaristi Goran Rafajllovski.

Sipas tij, një nga zgjidhjet e problemeve me tepicën e të punësuarve në administratë,

është që ai që ndjehet i aftë, t'i ofrohen paga për 24 muaj, me qëllim që të kalojë në sektorin privat. Njëherazi shteti duhet të jetë garant për kreditë deri në 500 mijë euro për afaristët që do të hapin vende të reja të punës.

Në ndërkohë, Ministria e Administratës ka paralajmëruar analizë funksionale që do të ofrojë pasqyrë reale për mënyrën e funksionimit të sektorit publik. Pas rezultateve të fituara pritet që një pjesë të punësuarve nga administrata t'i ofrohen biznesit. Firmat nën kushte të caktuara do të kenë mundësi të pranojnë një pjesë të punësuarve, për çka do të fitojnë edhe ndihmë shtetërore. Në këtë mënyrë pritet që të ulet numri i të punësuarve në administratën publike si dhe të shkurtohet numri i mjeteve që nga buxheti ndahet për administratën. Analiza më tej duhet të tregojë se sa do të jetë edhe kostoja për buxhetin e shtetit si dhe mënyrën se si do të përkrah transferi i të punësuarve. Qëllimi nuk është që dikush të mbetet pa punë, por që të rritet efikasiteti i administratës publike si dhe të ndihmohet zhvillimi i sektorit të biznesit.

Kultura i nënshtrohet revizionit

Shkup, 28 korrik - Ministria e Kulturës i dërgoi kërkesë Entit shtetëror për revizion për një revizion të jashtëzakonshëm për rregullshmërinë e punës së tyre. Këtë në konferencë shtypi e kumtoi ministri i Kulturës, Robert Allagjozovski në Galerinë e Hamamit të Daut Pashës. "Ministria e Kulturës ndodhet në një pozitë të rëndë financiare. Ne bëmë vlerësimin e projekteve, programeve dhe aktiviteteve të Ministrisë në vitin 2017, bashkë me 1 qershorin. Përcaktuam se mjetet për realizimin e projekteve në kuadër të programit vjetor të Ministrisë për 80 për qind janë harxhuar", tha Allagjozovski. Ai sqaroi se projektet janë paguar para kohe, madje edhe projekte të cilat nuk janë realizuar. "Këtë informacion e dorëzuam edhe në Qeveri, duke elaboruar se për disa projekte janë dakorduar edhe aneks marrëveshje me të cilat edhe mjetet të cilat janë paraparë prej më parë për disa projekte të caktuara janë më të mëdha se mjetet e miratuar fillimisht. Kërkuam nga Qeveria të sjellë konstatim në të cilin Ministria e Kulturës do të kërkojë prej Entit shtetëror për rishikim të bëjë revizion të jashtëzakonshëm për rregullshmërinë e punës së Ministrisë", theksoi Allagjozovski. Ministri i Kulturës pret përgjigje pozitive për kërkesën e tyre. Revizioni i fundit i rregullt në Ministrinë e Kulturës, siç tha, është bërë në vitin 2011, për punën në vitin 2010. I pyetur për borxhin e Ministrisë së Kulturës, Allagjozovski tha se ai është rreth 2,2 miliardë denarë. Paralajmëroi se për gjithë këtë do të pasojë përgjegjësi dhe shtoi se për këtë nevojitet revizioni. "Një revizion i jashtëm, i pavarur dhe në themel do të na çojë drejt arsyeshmërisë, do ta locojë përgjegjësinë në mënyrë precize dhe të gjitha shpenzimet. Ky raport i revizionit do të na ndihmojë të ndërmarrim masa përkatëse disiplinore, madje edhe përgjegjësi penale atje ku do ta përcaktojmë", potencoi Allagjozovski. Ministria e Kulturës tha nuk ka kërkuar mjete të reja me ribalancin e Buxhetit pasi që, siç tha, ato nuk janë të mundshme.

Mançevski: Ne kemi punësuar 96 persona, ata për tetë muaj 7.708

Shkup, 28 korrik - Prej 1 qershorit të këtij viti deri më tani nga ana e Qeverisë së re gjithsej janë punësuar 96 persona në të gjitha institucionet. Prej tyre, 32 janë këshilltarë të posaçëm të kabinetëve të ministrive, ndërsa 26 persona janë angazhuar në Qeveri si këshilltarë të kryeministrit, nëpunës kabinetesh të ministrave pa resor dhe persona për marrëdhënie me opinionin, saktësoi ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Damjan Mançevski në konferencën për shtyp. Ai theksoi se prej 1 qershorit të këtij viti



deri më 25 korrik përmes njësisive të vetëqeverisjes lokale janë punësuar mbi 300 persona. "Pjesa më e madhe e komunave janë

nën kontroll të partisë më të madhe opozitare dhe kjo tregon se çfarë është fama për partizim të ri të administratës", tha

Mançevski. Ai theksoi se qeveria e kaluar në periudhën prej shpalljes së zgjedhjeve më 17 tetor të vitit 2016 deri më 31 maj të këtij viti kur u formua Qeveria e re ka angazhuar gjithsej 7.708 persona edhe pse në pajtim me Kodin zgjedhor dhe Marrëveshjen e Përzihos nuk ishin të lejuara kurrfarë punësime dhe angazhime të personave. Vetëm më 17 tetor në ditën e shpalljes së zgjedhjeve ishin angazhuar 4.473 persona, ndërsa të tjerët 3.235 persona në ditët kur nuk ekzistonte kurrfarë baze ligjore për angazhime të

këtitilla. Nga ky numër më 17 tetor u angazhuar 2.313 persona me kontratë në vepër, marrëveshje autoriale apo kontrata për vullnetarizëm. Ai paralajmëroi raport të hollësishëm në të cilin do të prezantohen të dhënat dhe theksoi se është në fazë të përpunimit analiza funksionale, e cila pritet të jetë e gatshme deri në fund të vitit, me të cilën do të shihet numri i përgjithshëm i personave të angazhuar në administratën publike dhe do të bëhet riorganizimi. Në pajtim me rekomandimet e kryeministrit Zaev, disa

nga të punësuarit në administratë publike do të ofrohen në sektorin real në pajtim me nevojat e tyre. Ai paralajmëroi se do të zgjidhet edhe statusi i reth 1.600 personave të cilët rrinë në shtëpi, ndërkaq marrin rrogë. I pyetur se për cilin qëllim në ribalancin e Buxhetit është paraparë rritje e buxhetit të MSHIA-së prej 311 në 440 milionë denarë. Mançevski tha se teprica e mjeteve dedikohet për heqjen e takës radiodifuzive dhe shtoi se tekniku është përmes buxhetit të MSHIA-së do të financohet puna e RTVM-së.



Prokuroria e Publike e tha fjalën përmbyllëse për "Kumanovën"



Të akuzuarit nuk pranojnë të dënohen për "terrorizëm"

Pjesa dërmues e të akuzuarave e bojkotuan seancën përmbyllëse të prokurorisë, duke theksuar se nuk janë interesuar të dëgjojnë pallavrat. Në këtë mënyrë i akuzuari Fatmir Reçica, para largimit nga salla gjyqësore tha se ai pranon të gjykohe, por vetëm në cilësinë e ushtarit të UÇK-së, dhe jo sipas akuzës aktuale të cilën prokuroria e ka ngritur

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 28 korrik - Hyrja ilegale në Maqedoni, sasia dhe llojllojshmëria e arsenalit luftarak, veprat penale të kryera në Gushincë dhe Lagjen e Trimave, janë tregues të mjaftueshëm se 37 të akuzuarit nga grupi i "Kumanovës" kanë kryer veprën penale "terrorizëm" dhe "organizatë terroriste". Kështu tha prokurori publik Naum Panovski në fjalët përfundimtare në procesin gjyqësor për "Lagjen e Trimave" të premtën para trupi gjyqësor, ku kërkoi që të akuzuarve t'ju shqiptohen dënime në bazë të normave dhe dispozitivave ligjore. Ndërkohë, për vendimin dhe lartësinë e dënimeve, prokurori Panovski theksoi se fjalën e fundit duhet ta ketë trupi gjyqësor. "Në bazë të dëshmiave verbale dhe materiale që i kemi publikuar brenda këtij procesi gjyqësor, është vërtetuar se të akuzuarit janë kryerës të veprës penale për të cilën ngarkohen. Ndërkohë, deklaratat e dhëna nga të akuzuarit nuk janë përpëthur, gjegjësisht të akuzuarit shpesh herë e kanë potencuar se mos implementimi i Marrëveshjes së Ohrit ka qenë shkak se pse kanë hyrë të armatosur në Maqedoni, me qëllim mbajtjen e një konference për shtyp. Mirëpo, këtë tezë ata e kanë kundërshtuar me faktin se paraprakisht nuk kanë vendosur kontakte me përfaqësuesit diplomatike në vend dhe partitë politike", tha Panovski.

Kodi Penal i Maqedonisë, në pjesën e veprave për "terrorizëm" parasheh burg nga tetë deri në dënime kapitale me burg të përjetshëm, gjegjësisht për veprën penale "organizatë terroriste", dënimet lëvizin nga katër, dhjetë apo më shumë vite dënime me burg.

Pjesa dërmues e të akuzuarave e bojkotuan seancën përmbyllëse të prokurorisë, duke theksuar se nuk janë interesuar të dëgjojnë pallavrat. Në këtë mënyrë i akuzuari Fatmir Reçica, para largimit nga salla gjyqësore tha se ai pranon të gjykohe, por vetëm në cilësinë e ushtarit të UÇK-së, dhe jo sipas akuzës aktuale të cilën prokuroria e ka ngritur. "Unë pranoj të gjykohe, por jo si terrorist.

Nëse vazhdoni të na trajtoni dhe gjykoni si të këtyllë, atëherë duhet ta ftoni edhe Talat Xhaferin, për shkak se edhe ai ka qenë pjesë e UÇK-së", tha Reçica. Pavarësisht se trupi gjyqësor të akuzuarve, të cilët një kohë të gjatë rebelohen dhe nuk e pranojnë këtë proces gjyqësor, nuk ju dha fjalën të premtën, i akuzuari Genci Sefaj, tha se lartësia e dënimit për atë nuk ka asnjëfarë ndikimi, por se atyre u është

cenuar e drejta ligjore e mbrojtjes. "Avokatët punojnë për ne, po as ne nuk po na bindin.

Janë duke punuar nën presion", theksoi Genci Sefaj, duke lëshuar sallën ku po mbahej seanca gjyqësore për rastin e "Lagjes së Trimave". Ndryshe, Bajram Elshani, ka reaguar ndaj qëndrimit të prokurorit Naum Panovski, i cili tha se të akuzuarit nuk e kanë vërtetuar faktin se dikush i ka thirrur që të vijnë. "Sadulla Duraku dhe Ejup Alimi duhet të jenë këtu. Ju të gjithë do të pendoheni për këtë punë që jeni duke e bërë", e ka kujtuar kështu Bajram Elshani prokurorin dhe gjykatën. Procesi gjyqësor për "Lagjen e Trimave" është paraparë të vazhdojë më 30 dhe 31 gusht, me çka deri atëherë pala mbrojtëse e të akuzuarve duhet të përgatitë fjalët përfundimtare.

Ndryshe, për muajin shtator janë caktuar mbi 7 seanca gjyqësore, kur edhe pritet që të akuzuarit t'i thonë fjalë përmbyllëse dhe eventualisht të japin ndonjë detaj tjetër nga ngjarjet e prillit dhe majit të vitit 2015 që ndodhën në Kumanovë dhe rrethinë.

Shkup, 28 korrik - Për arratisjen e Goran Grujoskit dhe Nikolla Boshkovskit, përgjegjësia bie mbi sistemin gjyqësor. Ky është qëndrimi i Ministrit të Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, i cili dy ditë pasi të akuzuarit e lëndëve gjyqësore "Target" dhe "Fortesa" u arratisën, tha se doemos duhet të bëhen reforma edhe në sistemin juridik vendas. "Ky nuk është dështim i policisë, por vetëm vërtetohet fakti se sa i kalbur është sistemi gjyqësor në Maqedoni. Si ne, ashtu edhe opinionin, përgjegjësinë duhet ta kërkojmë nga gjykatësit. Për këtë çështje, gjithashtu duhet të bartet përgjegjësi, për shkak se të akuzuarve ju dha mundësia të arratisen jashtë shtetit ose të fshihen brenda vendit. Sidoqoftë, kjo duhet të jetë një porosi e fuqishme, por edhe një mësim i qartë për reformat që pasojnë në sistemin e jurisprudencës në vendin tonë", tha ministri Spasovski. Sipas tij, e nevojshme është që të kërkohet përgjegjësi nga ata persona, të cilët ju mundësojnë kriminelëve të shëtiten të lirë. Ndryshe, odiseja e vënies prapa grilave e dy nëpunësve të Drejtorisë për Siguri dhe Kundërsbulim, u zyrtarizua me 18 korrik, megjithatë praktika e gjyqësore e krijuar më parë me afaristin Sead Koçan, i mundësoi palës mbrojtëse ankimimin e vendimit të plotfuqishëm për paraburgim para Gjykatës së Lartë, e cila e vërtetoi, mirëpo të akuzuarit, brenda kësaj kohe, janë kujdesur që të arratisen. (O.XH.)

Spasovski: Gjykatësit përgjegjës për arratisjen e Grujoskit dhe Boshkovskit

Në 11 fatkeqësi komuniacioni, tre persona të lënduar rëndë

Shkup, 28 korrik - Në Shkup gjatë 24 orëve të fundit janë evidentuar 11 fatkeqësi komunikacioni. Në dy prej tyre më rëndë janë lënduar dy persona, në tre fatkeqësi më lehtë janë lënduar tre persona, ndërsa në gjashtë fatkeqësi është shkaktuar vetëm dëm material. Policia rrugore gjatë ditës së djeshme sanksionoi 10 vozitës të cilët kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se e lejuara, ndërsa tre vozitës e kanë drejtuar automjetin nën ndikim të alkoolit dhe janë përjashtuar nga trafiku. Tre vozitës kanë kaluar në dritë të kuqe të semaforit, katër nuk e kanë shfrytëzuar rripin e sigurimit apo kanë folur në telefon celular, 23 vozitës e kanë drejtuar automjetin pa patent shofer, përkatësisht të paregjistruar. Janë hasur 49 automjete të parkuara në mënyrë të parregullt. Me automjetin e posaçëm janë mënjnuar gjithsejt 55 automjete.

Lirohet nga të gjitha akuzat Lirim Jakupi



Prishtinë, 28 korrik - Lirim Jakupi, ish-luftëtari i tri luftërave në trojet shqiptare, atë të Kosovës, të Luginës së Preshevës, Medvegjës e Bujanocit, si dhe luftës së Maqedonisë është liruar nga gjitha akuzat që kishte. Dihet se Lirim Jakupi ishte përballur me shumë akuzë nga drejtësia si ajo vendore, serbe e ndërkombëtare për krime lufte. Për veprat e kryera në Maqedoni gjatë periudhës

shtator-dhjetor 2014, Lirim Jakupi akuzohej nga EULEX-i. Ndaj Jakupit edhe ishte ngritur aktakuza për kryerje të vrasjes së rëndë në tentativë, shkaktim të lëndimit të rëndë trupor dhe sulm kundër personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrës. Rasti sipas EULEX-it ka të bëjë me pretendimet që i pandehuri, në shtator dhe në dhjetor 2004, ka sulmuar dhe ka hapur zjarr ndaj zyrtarëve

policorë në Shkup dhe në Tetovë duke iu shkaktuar lëndime të rënda. Gjatë aksionit policor për kapjen e tij në Tetovë mbeti i varë edhe një student, ndërsa ishte pjesë edhe e grupit të "Brodecit", ku gjatë aksionit policor "Stuhia Malore" mbetën të vrarë disa disa persona, kurse ai ishte arratisur. EULEX pretendon se Lirim Jakupi iku nga vendi i krimit. Ai u arrestua në Kosovë në

janar të vitit 2014 dhe prej atëherë ka qenë në paraburgim. Ky ishte një hetim i përbashkët i kryer nga hetuesit e EULEX-it të njësitit të krimit të organizuar së bashku me prokurorët dhe hetuesit nga Republika e Maqedonisë ka sqaruar EULEX-i. Ai përjetoi burgjet e UNMIK-ut, burgjet e Kosovës, EULEX-it, Maqedonisë, KFOR-it, Serbisë dhe shumë procese tjera. (RTK)



Rusia dhe Turqia nxisin trazira, SHBA s'mendon për një tjetër luftë në Ballkan, ndërsa BE-ja po përqendrohet në problemet e veta. Perspektiva e anëtarësimit në BE për vende si Serbia, Maqedonia, Mali i Zi, Kosova dhe Bosnja ka bërë më shumë se çdo gjë tjetër për të mbajtur paqen e brishtë në Ballkanin Perëndimor. Çdo vend ballkanik do të dëshironte më tepër të ishte pjesë e BE-së sesa të ishte aleate e Rosisë apo Turqisë

Analizë e gazetës amerikane Wall Street Journal

Ballkani, kriza e ardhshme e Evropës



Uashington, 28 korrik - Në një takim të mbyllur të kohëve të fundit, me ekspertë, një zyrtar i mirënformuar gjerman u pyet se cili është problem që e shqetëson atë më së shumti në Evropë. Përgjigjia e tij erdhi pa hezitim: Ballkani Perëndimor, ku një krizë e re po krijohet, teksa Turqia dhe Rusia po trazojnë çorbën, shkruan Wall Street Journal, transmeton Lapsi.al. Në skenarin e tij më të keq, Rusia dhe Turqia do të inkurajojnë "të afërmit" e tyre në Ballkan, Serbinë dhe Shqipërinë, për t'i ndihmuar që të rivizatojnë kufijtë e rajonit. Qeveria serbe, me mbështetjen e Rosisë, mund të aneksonte pjesë të mëdha të Bosnjës së populluara nga serbët etnikë. Mbështetja turke mund të ndihmojë Shqipërinë të marrë një manovër të ngjashme, jo vetëm në Kosovën shqiptare, por edhe në Maqedoni, ku shumica e minoritetit të madh shqiptar dëshirojnë të ribashkohen me atdheun. Ky kurs i ngjarjeve vështirë se mund të ndodhë, shkruan WSJ. Derisa disa nga territoret e pretenduara nga Shqipëria e Madhe janë në Serbi, do të ishte e vështirë për të dy vendet të bien dakord mbi një hartë të re. Por ky nuk është një rezultat i pamundur, edhe nëse ideja ka më shumë gjasa të frymëzojë ndonjë tip alla James Bond se sa një ministër të jashtëm. Dhe një numër gjithnjë e më i madh i batakçinjve të tipit të Bondit duket se po shfaqet në politikën botërore këto ditë. Ekziston një realitet i rëndë i cili bazohet në shqetësimet e Gjermanisë. Ballkani po zhblokohet dhe Perëndimi tani duhet të shqetësohet për më shumë se ndërhyrjet ruse. Turqia po bëhet gjithnjë e më

shumë një NINO (NATO vetëm në emër) me pushtet dhe pavarësisht nga dyshimet e thella të Turqisë ndaj Rosisë, Presidenti Rexhep Tajip Erdogan po bashkëpunon më ngushtë me Presidentin Vladimir Putin. Turqia dhe Rusia janë bashkuar nga kundërshtimi i tyre ndaj Gjermanisë dhe Bashkimit Evropian. Rusët jo vetëm e urrejnë NATO-n; Ata e shohin BE-në si pengesë ndaj rolit historik të fuqisë së Rosisë në çështjet evropiane. Turqia po ashtu është kthyer kundër BE dhe po kërkon leva kundër Gjermanisë dhe anëtarëve të tjerë të saj. Për Rusinë dhe Turqinë, aftësia për t'i shkaktuar Europës probleme në Ballkan, me rrezik dhe kosto relativisht të vogël, është diçka që s'mund të lihet pasdore. Perspektiva e anëtarësimit në BE për vende si Serbia, Maqedonia, Mali i Zi, Kosova dhe Bosnja ka bërë më shumë se çdo gjë tjetër për të mbajtur paqen e brishtë në Ballkanin Perëndimor. Çdo vend ballkanik do të dëshironte më tepër të ishte pjesë e BE-së sesa të ishte aleate e Rosisë apo Turqisë. Por shpresat për anëtarësim afatshkurtër në BE po veniten. Evropa po humbet Britaninë dhe ka pasur kohë të vështira në menaxhimin e marrëdhënieve me anëtarët si Hungaria dhe Polonia. 28-ta

shpejti do të jetë 27 - anëtarët e BE-së që kanë pak dëshirë për të marrë pesë shtete të reja ballkanike, të cilat do ta bënin bashkimin edhe më të padobishëm dhe do të prisnin ndihmë financiare në një kohë kur buxheti i BE, pas Brexit, do të tendoset. Serbët dhe shqiptarët po sinjalizojnë se nëse Perëndimi largohet, ata do të duhet të shohin nga lindja dhe kjo do të thotë të kalosh në një agjendë nacionaliste me ndihmën ruse dhe turke. Për BE-në, një raund i ri i kaosit të Ballkanit do të ishte një fatkeqësi: refugjatët, krimi, radikalizimi mes myslimanëve të Ballkanit, mundësi më të mëdha për fuqitë armiqësore për të fituar ndikim në shpenzimet e BE. Por BE nuk mendon se mund ta menaxhojë vetë Ballkanin. Shtetet e Bashkuara do të duhet të jenë pjesë e zgjidhjes, thonë gjermanët. Do ta luajë në SHBA topin? Angazhimi në grindjet e Ballkanit të largët për t'ia bërë jetën më të lehtë të Gjermanisë nuk është pikërisht ideja e Donald Trump për politikën e jashtme. Bill Clinton luftoi për dy vjet për të mbajtur Shtetet e Bashkuara në luftërat e pas-Jugosllavisë. Z. Trump mund të jetë akoma më skeptik për ndërhyrjen dhe për të trajtuar mundësinë e një raundi të ri të luftërave ballkanike me nd-

eshmërinë e ftohtë që Barak Obama shfaqti në Siri. Ky do të ishte një gabim i rëndë. Ndonëse grindjet në Ballkan janë të parëndësishme krahasuar me problemet më të mëdha në vende të tjera, ajo që ndodh në Ballkan nuk qëndron gjithmonë në Ballkan, dhe NATO dhe BE mund të tronditen në thelb nga një tjetër raund gjakderdhje në Ballkan. Kriza ka potencialin për të ripërcaktuar marrëdhëniet e SHBA-së dhe BE-së për dekada të tëra. Europeanët argumentojnë se investimet relativisht të vogla, afatshkurtra amerikane - diplomacia aktive dhe ndërtimi i forcave amerikane në Kosovë - mund të ishin më shumë. Por ne kemi një president që nuk mund ta gjejë bindës këtë argument. Fokusi kryesor i z. Trump për politikën e jashtme duket të jetë se SHBA u ka lejuar aleatëve të saj të gëzojnë një rrugëtim të lirë dhjetëra vjeçar. Evropianët që shqetësohen për paqen e Ballkanit duhet të mendojnë se si mund ta bindin një Shtëpi të Bardhë skeptike për t'u angazhuar. Ankesat e vjetra - ndaj solidaritetit të NATO-s, mbrojtjes së lirisë, frikës nga Rusia - mund të mos jenë të mjaftueshme. Z. Trump mendon për marrëveshje dhe Berlioni duhet të mendojë se si ta ulë atë në tavolinë.

Nismë për kyçe të sektorit privat në dhënien e shërbimeve sociale

Shkup, 28 korrik - Sektori privat të kyçet në dhënien e shërbimeve sociale dhe të përpilojë rregullore ligjore që do ta rregullojë këtë veprimtari, parashikon Nisma për vendosjen e modelit të marrëveshjeve sociale të SOS Fshatit të Fëmijëve dhe UNICEF-it. Nisma realizohet nga viti 2014, ndërsa sot u prezantuan zyrtarisht dokumentet të cilat dolën nga ajo pas çka iu dorëzuan ministres së Punës dhe Politikës Sociale Mila Carovska. "Me këtë Nismë synuam drejtë mbindërtimit dhe përmirësimit të legjislacionit kombëtar. Shpresojmë se të gjitha vendimet jo vetëm që do të pranohen, por edhe do të shfrytëzohen dhe implementohen. Kjo do të thotë se shteti do të ketë mundësi të rregulluar ligjërisht të angazhojë ofertues privat të shërbimeve sociale që do të kontribuojë për cilësi më të lartë të shërbimeve, palëtë më e gjerë të shërbimeve dhe qasje më të madhe të tyre deri te shfrytëzuesit e fundit", theksoi drejtoresha kombëtare e SOS Fshatit të fëmijëve Julijana Gapo. Sipas saj, me modelin e marrëveshjeve sociale qartë janë përcaktuar obligimet e palëve të përfshira. Institucionet do ta mbajnë përgjegjësinë për financimin e shërbimeve, do të krijojnë kornizë ligjore për licencim dhe regjistrim të ofertuesve të shërbimeve sociale, do t'i konfirmojnë kriteret për cilësi, do t'i ndjekin rezultatet dhe do të reagojnë kur do të ketë nevojë, do të vendosin kush i përmbush kushtet për dhënien e shërbimeve të tilla dhe kush do t'i sigurojë. Ministria Carovska e përshëndeti Nismën, duke theksuar se vjen në moment të vërtetë, kur Ministria përballet me sfidën të zbatojë reforma thelbësore. "Sistemi për siguri sociale duhet të fitojë pasqyrë adekuate për shekullin 21 dhe t'i ndjek trendet ndërkombëtare. Lidhur me shërbimet sociale sa dhe cilat janë mjete financiare duhet të transferohen drejtë qytetarëve të cilët materialisht janë të pasiguruar ose janë në rrezik tjetër social, analizat tregojnë se Maqedonia jep mjete financiare dhe shërbime të caktuara sociale ofrohen, por efekti përfundimtar humbet diku gjatë rrugës", theksoi Carovska. Ajo paralajmëroi jo vetëm miratim të rregullores së re ligjore, por edhe implementimin e saj në praktikë. "Reformat do të bazohen në dy punë kyçe: transferimet sociale ndaj qytetarëve do të grupohen dhe do të arrijnë nivelin e cili do të jep efekt për dalje nga varfëria, si dhe rregullimin e të gjitha shërbimeve sociale", thekson ministrja. I përbashkët ishte konkluzioni se Qeveria duhet t'i garantojë të drejtat e njeriut, të jetë partner dhe të punojë së bashku me sektorin civil dhe gjithmonë të sigurojë shërbime cilësore sociale.

Të hënën dezinfektimit në Shkup

Shkup, 28 korrik - Qyteti i Shkupit kumtoi se dezinfektim teristik (i tokës) kundër larvave të mushkonjave në rajonin e Shkupit do të realizohet

të hënën në periudhën prej orës 07:00 deri 17:00. Me këtë dezinfektim, siç theksohet, do të përfshihen sipërfaqe ujore në qytetin e Shkupit dhe

rrethinën e saj. Nëse kushtet e motit nuk e lejojnë kryerjen e dezinfektimit teristik, ajo do të bëhet ditën tjetër të ardhshme, kur kushtet e motit do të jenë

të volitshme, informojnë nga Qyteti i Shkupit dhe u bënë thirrje bletarëve në kohë t'i ndërmarrin masat e nevojshme për mbrojtjen e bletëve.

Ministri Saliji kërkon bashkëpunim për reformat

Shkup, 28 korrik - Në Ministrinë e Drejtësisë është realizuar takim koordinues me të gjitha institucionet përkatëse, organizatat dhe shoqatat lidhur me Strategjinë për reforma në sektorin e gjyqësorit. Takimin e hapë dhe e udhëhoqi ministri i Drejtësisë, Bilën Saliji, ndërsa fjalim mbajtën edhe zëvendësministri i Drejtësisë, Oliver Ristovski, si dhe kryetarja e



grupit të punës për hartimin e Strategjisë për reforma në sektorin e gjyqësorit, Prof. Dr. Ana

Pavlovska-Daneva. Ministri mbajti një fjalim të shkurtër për Planin 3-6-9 të Qeverisë për të zbatuar "Prioritetet urgjente të reformës". Ai potencoi se Ministria e Drejtësisë është bartës kryesor i reformave në gjyqësi së bashku me të gjithë faktorët e sistemit të gjyqësorit. Ai gjithashtu theksoi se qëllimi i këtij takimi është përfshirja aktive dhe pjesëmarrja e të gjithë

faktorëve të gjyqësorit në procesin e hartimit të Strategjisë. Të pranishmit u informuan se në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë është formuar grup punues për hartimin e Strategjisë për reformën sektorit të gjyqësorit me Planin e veprimit. Pas një debati dhe diskutimi të hapur, ministri Saliji i ftoi të pranishmit në takim që të japin kontribut të sinqertë

dhe konstruktiv për reformën, në një mënyrë që të gjitha vërejtjet, sugjerimet, hulumtimet, mendimet dhe qëndrimet e tyre t'ia paraqesin grupit të punës për hartimin e Strategjisë në Ministrinë e Drejtësisë. Ministri theksoi pritjet e tij për bashkëpunim të suksesshëm dhe përfundim të suksesshëm të të gjithë faktorëve të sektorit të gjyqësorit.



Liqeni i Dibrës si shpëtim nga temperaturat e larta

Uji i pastër si asnjëherë deri tani

Institucioni kompetent , Enti për shëndet publik Ohër, njësia në Dibër, ka kumtuar se uji në Liqenin e Dibrës, në pjesën dërmuese të plazhit është i klasit të parë

Koha Vjollca SADIKU

Dibër, 28 korrik- Dibranët, aktualisht në këto temperatura të larta freskinë e gjejnë në ujërat e Liqenit të Dibrës. Bregu i Liqenit këto ditë është përplot me pushues, të cilët pa probleme freskohen me ujin, i cili sipas Njesisë për shëndet publik në Dibër, i plotëson të gjitha standardet për larje. Ajo këto ditë është e mbushur përplot me vizitor.

Institucioni kompetent , Enti për shëndet publik Ohër, njësia në Dibër, ka kumtuar se uji në Liqenin e Dibrës, në pjesën dërmuese të plazhit është i klasit të parë. Kjo do të thotë se pushuesit nuk duhet të shqetësohen në lidhje me kualitetin e ujit. Epidemiologu Mentor Mela, thekson se në konti-



nuitet bëhen analizat e ujit në pesë lokacione, kryesisht në pjesët ku është plazhi i liqenit dhe uji në fjalë është sipas kriterëve. Po ashtu, sipas tij, edhe në hyrje të Lumit Radikë dhe Lumit Drini i Zi, janë regjistruar analizat të klasit të parë dhe të klasit të dytë që do të thotë se uji i liqenit është i pastër për larje, sipas standardeve përkatëse. Mela gjithashtu shton se do të vazhdojmë me një dinamik të veçantë analizat e ujit, me qëllim që tërësisht të mbrohet shëndeti publik i popullatës.

Në krahasim me vitet e kaluara, sivjet kemi një ujë më të pastër të liqenit, theksojnë në njësinë për shëndet publik në Dibër. Sipas tyre, ka pasur raste viteve të kaluara kur disa pjesë të liqenit, edhe atë ku janë disa objekte shërbyese, uji i liqenit ka qenë edhe i klasit të tretë që faktikisht ka pasur ndalesë për freskim në ujë. Duke ndërmarrë aktivitete të ndryshme, sidomos nga ana e inspektorëve kompetentë, në bashkëpunim me Entin për shëndet publik, situata këtë vit dukshëm është

përmirësuar dhe analizat e fundit të ujit të realizuara në liqenin e Dibrës, në pjesën më të madhe janë shumë të mira. që do të nuk ka pengesa për freskim. Sivjet filloi të funksionojë edhe ekipi i shpëtimtarëve që është projekt i financuar nga Shoqata atdhetare "Dibra", me seli në Nju Jork, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq komunal, me çka tani më në Liqe janë rojet e shpëtimtarëve që ndjekin lëvizjet e pushuesve në ujëra.

Në drejtim të rritjes së vetëdijes të mbrojtjes së

MENTOR MELA

“ Në kontinuitet bëhen analizat e ujit në pesë lokacione, kryesisht në pjesët ku është plazhi i liqenit dhe uji në fjalë është sipas kriterëve. Po ashtu, edhe në hyrje të Lumit Radikë dhe Lumit Drini i Zi, janë regjistruar analizat të klasit të parë dhe të klasit të dytë që do të thotë se uji i liqenit është i pastër për larje, sipas standardeve përkatëse

kualitetit të ujit të Liqenit, kontribut japin edhe pronarët e objekteve shërbyese që funksionojnë në bregun e liqenit. Bëhet fjalë për afro dhjetë kafe restorante, të cilët funksionojnë sidomos gjatë sezonit veror dhe që pushuesve ju ofrojnë ushqime dhe pije të ndryshme freskuese. Kohëve të fundit, duke marrë parasysh rregullimin e rrugës të liqenit me trotuare dhe ndriçim. Një numër i madh i qytetarëve dibranë në bregun e liqenit janë duke ndërtuar objekte jolegale. Nga pushteti vendor, sektori për urbanizëm kanë paralajmëruar shumë shpejt aprovimin e planit detal edhe për zonën e bregut të Liqenit të Dibrës. Me këtë plan dhe dokumente

urbanistike, një vëmendje e veçantë i kushtohet mbrojtjes së mjedisit jetësor, respektivisht të ujërave të zeza që do të dalin nga objektet që janë dhe të cilët planifikohen të bëhen në këtë pjesë periferike të qytetit. Me planin është paraparë ndërtimi i një sistemi për pastrimin e ujërave të zeza, me çka garantohet mbrojtja e mjedisit jetësor të bregut të Liqenit dhe mbrojtja e kualitetit të ujit. Duke marrë parasysh se me planin në këtë pjesë të Dibrës pritet ndërtimi i hoteleve, objekteve afariste, terreneve sportive dhe relaksuese, mbrojtja e ujit të Liqenit është nevojë e patjetërsueshme për zhvillimin e një turizmi të kësaj pjese të Komunës Dibër.

Me pianisten Meri Kavkaleva – Stoilkova

Kujt i pengon përkatësia ime kombëtare?

Që kur u deklarova publikisht se jam shqiptare, filluan të më injorojnë maqedonasit, mjerisht më injorojnë edhe shqiptarët

Koha Qenan HASANI

Manastir, 28 korrik - Çdo takim me shqiptaren ortodokse, profesoreshën e muzikës në Fakultetin pedagogjik në Manastir, pianisten e njohu Meri Kavkaleva – Stoilkova, është edhe një provokim për të shkruar për këtë zonjë të vërtetë, e cila nuk ngushtohet kurrë të thotë se i takon kombit më të çiltër, kombit të Skënderbeut të madh. Kështu ndodhi edhe këto ditë të kësaj vere me temperatura tropikale. Krejt pa pritmas, ajo me bashkëshortin e saj, violinistin Vanço Stoilkov, mjeshtri i parë që ia mësojë notat e para në violinë violinistes sonë të madhe, profesoreshës Sihana Badifuku, gjatë përfundimit të një projekti televiziv.

Meri me një kulturë të lartë muzikore, gjatë karrierës, së bashku me bashkëshortin të saj, shtatë vite i ka kaluar në Universitetin e Prishtinës, vite që kanë mbetur thellë në kujtesën e saj, nga se, siç shprehet gjatë bisedave, "isha në mesin e



vëllezërve të gjakut, ndjehesha si dallëndyshe në fluturim". Ndërkaq, ajo edhe si profesoreshë në Fakultetin Pedagogjik të Manastirit, ka pasur punë edhe me studentë shqiptarë, me të cilët ka komunikuar në gjuhën shqipe, bile edhe përkundër ligjeve diskriminuese ndaj gjuhës shqipe, ajo u ka mundësuar studentëve shqiptarë provimet t'i japin në gjuhën shqipe, këtë vetëm nga dashuria e madhe ndaj gjuhës që, me kalimin të kohës, për shkak të moskomunikimit, një fond të fjalëve i ka harruar, andaj edhe dëshira e saj të komunikojë me shqiptarë.

Gjatë bisedës së fundit, ajo u ankua se pas deklarimit publik se me origjinë është puro shqiptare, kanë filluar skajshmërisht ta injorojnë dhe ta diskriminojnë, jo vetëm atë, por edhe të shoqin që

është me përkatësi bullgare, por i jashtëzakonshëm si njeri. Atij kur nuk i pengon kur Meri me miqtë e saj shqiptarë flet shqip, bile edhe e shtynë që të mos e harrojë gjuhën e kishin të qartë se unë jam shqiptare, me angazhonin nëpër manifestimet të ndryshme kulturore,

Këtyre tre – katër viteve, edhe përkundër manifestimeve të dendura gjatë tërë vitit, nuk e kanë përfillur.

"Injorimi dhe diskriminimi im nga ana a maqedonasve është pasojë e deklarimit tim si puro shqiptare. Kjo mund të ndodhe me një popull të ngarkuar me paragjykimet edhe fetare, edhe kombëtare. Unë, nuk e di se në ç'mënyrë u pengon përkatësia ime kombëtare. Me këtë që bëjnë

bashkëvendësit tanë, dëshmojnë nivelin e tyre të civilizimit", shprehet e revoltuar mjeshtrja e pianos, Kavkaleve.

Mjerisht, për shkak të përkatësisë fetare, injorimi vjen edhe nga shqiptarët, edhe pse kjo ka dëshirë të madhe të prezantohet nëpër manifestimet kulturore të shqiptarëve, sidomos në manifestimet kushtuar përvjetorëve të Kongresit të Alfabetit. "Kongresi i Alfabetit nuk është ngjarje vetëm për historinë e shqiptarëve myslimanë, por është i të gjithë shqiptarëve, pa dallim feje. Shumica e atyre burrave që vunë themelet e shtetit shqiptarë, themelet e gjuhës shqipe, ishin edhe ortodoksë, thotë ajo, për të shtuar se deri më tani e ka ftuar vetëm një miku i saj, kur ka qenë organizator i shënimit të përvjetorit, kur u prezantua para mysafirëve. Ne, qofshim ortodoksë apo myslimanë, duhet ta kemi të qartë se jemi të një gjaku, për nga gjaku jemi vëllezër. Një anatemi e këtille do të na përcjelli deri sa nuk kuptojmë se vetëm bashkimi i shqiptarëve të Ballkanit, mund të jetë perspektiva e shqiptarëve. Përndryshe ndasitë do të na përcjellin edhe shumë shpejt, e shpartallojmë rininë tonë të bukur", përfundon reagimet dhe pakënaqësitë Meri Kavkaleva – Stoilkova.



Gostivari pjesë e Projektit të punësimit të UNDP

Gostivar, 28 korrik - Në Komunën e Gostivarit nisi puna për projektin e promovimit e tregjeve përfshirëse të punës. Ky projekt, që synon shtimin dhe lehtësimin e punësimeve në disa vende të rajonit, realizohet nga UNDP (Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara) dhe ILO (Organizata Ndërkombëtare e Punës), të cilat kanë zgjedhur Gostivarin si qytetin ku do të pilotohet projekti në Maqedoni. Në kuadër të këtij projekti, dy organizatore të UNDP dhe një konsulent i jashtëm janë takuar me Kryetarin e Komunës z. Nevzat Bejta. Znj. Vesna Bisheva dhe Valentina Nuskova të UNDP dhe Visar Ademi në rolin e konsulentit informuan z. Bejta rreth detajeve dhe zgjatjes në kohë të projektit.

Në drejtim të aktiviteteve të planifikuara

organizatorët mbajtën më pas një takim pune me përfaqësues të Agjencisë për Punësim, Sektorit të Biznesit, administratës komunale dhe OJQ-ve. Në takim u diskutua rreth mundësive dhe potencialeve të Gostivarit. Disa nga pyetjet e trajtuara ishin: Cilat janë grupet me prioritet për punësim në Gostivar? Cilat janë barrierat që p a m u n d e s o j n e punësimin e të rinjve? Cilat janë praktikatat pozitive që mund të përdoren? Projekti i përbashkët regional "Promovimi i tregjeve përfshirëse të punës" (Promoting Inclusive Labour Markets) implementohet në shtetet e rajonit të Ballkanit: Maqedoni, Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të zi dhe Serbi. Komuna e Gostivarit është zgjedhur si pilot komunë për Maqedoninë.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16 dhe 142/16”) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 90/15”), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të Punësuarve në Sektorin Publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14 dhe 27/16”) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrimit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejtshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 34/15”), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 26/2017

për punësimin e 8 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Komunën e Kërçovës” për vendet e punës në vijim:

1. UPR 01 01 V04 000 Bashkpunëtor i ri 1 realizues(ë)
për koordinim të aktiviteteve dhe punëve
protokollare të Prefektit, Njësia për
koordinim të aktiviteteve të Prefektit,
Sektori për përkrahje të Prefektit

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1 - Shkencat Juridike, Shkencat Ekonomike ose Shkencat e Letërsisë
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombtarisht e të lëshuar nga testatorët oficialë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve evropianë të nivelit A2 të CEFR, përkatësisht KET, IELTS me 3 pikë maksimum, BULATS, ose TOEFL PBT së paku 400 pikë, TOEFL CBT së paku 95 pikë, ose TOEFL IBT së paku 30 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose certifikatë Gete.

Njohja e gjuhës angleze mund të dëshmohej edhe me dorëzim të certifikatës së pranuar ndërkombëtarisht nga STANAG 6001 standarde të NATO-s në nivelin përkatës, ku nëpunësit administrativë nga kategoria V duhet të posedojnë certifikatë me STANAG 1+1+1+1+

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 19.708,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2017 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

2. UPR 01 01 V04 000 Bashkpunëtor i ri 1 realizues(ë)
për përkthim nga gjuha shqipe në
maqedone dhe anasjelltas për seanca të
Këshillit dhe trupat punues të Këshillit
dhe administrates së komunës, Njësia për
punë të këshillit dhe trupave punues të
këshillit, Sektori për punë juridike, të
përgjithshme dhe organizative

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1 - Shkencat e Letërsisë, Arsimit ose Shkencat Juridike
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik

- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombtarisht e të lëshuar nga testatorët oficialë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve evropianë të nivelit A2 të CEFR, përkatësisht KET, IELTS me 3 pikë maksimum, BULATS, ose TOEFL PBT së paku 400 pikë, TOEFL CBT së paku 95 pikë, ose TOEFL IBT së paku 30 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose certifikatë Gete.

Njohja e gjuhës angleze mund të dëshmohej edhe me dorëzim të certifikatës së pranuar ndërkombëtarisht nga STANAG 6001 standarde të NATO-s në nivelin përkatës, ku nëpunësit administrativë nga kategoria V duhet të posedojnë certifikatë me STANAG 1+1+1+1+

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 19.708,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2017 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

3. UPR 01 01 G04 000 Referent i ri për 1 realizues(ë)
punë profesionale administrative, Njësia
për arsim, shëndetësi, mbrojtje sociale
dhe mbrojtje të fëmijëve, Sektori për
arsim, kulturë, sport, shëndetësi, mbrojtje
sociale dhe mbrojtje të fëmijëve

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VA ose niveli i kualifikimeve IV, sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 ose 240 kredi sipas ECVET ose SMKAP ose së paku arsim të lartë ose të mesëm - Gjinnaz ose Kujdes shëndetësor (motër medicinale)
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombtarisht e të lëshuar nga testatorët oficialë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve evropianë të nivelit A1 të CEFR, përkatësisht BULATS, ose TOEFL PBT së paku 310 pikë, TOEFL CBT së paku 35 pikë, ose TOEFL IBT së paku 10 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose certifikatë Gete.

njohja e gjuhës angleze mund të dëshmohej edhe me dorëzim të certifikatës së pranuar ndërkombëtarisht nga STANAG 6001 standarde të NATO-s në nivelin përkatës, ku nëpunësit administrativë nga kategoria G duhet të posedojnë certifikatë me STANAG 1111

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 13.148,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2017 janë të parapara: Turk(e) 1.

4. UPR 01 01 V04 000 Bashkpunëtor i ri 1 realizues(ë)
për punë administrative nga sfera e
kontabilitetit, Njësia për kontabilitet dhe
pagesa, Sektori për çështje financiare

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1 - Shkencat Ekonomike ose Shkencat e Organizimit dhe udhëheqje (menaxhment), ose administratë publike
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombtarisht e të lëshuar nga testatorët oficialë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve evropianë të nivelit A2 të CEFR, përkatësisht KET, IELTS me 3 pikë maksimum, BULATS, ose TOEFL PBT së paku 400 pikë, TOEFL CBT së paku 95 pikë, ose TOEFL IBT së paku 30 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose certifikatë Gete.

Njohja e gjuhës angleze mund të dëshmohej edhe me dorëzim të certifikatës së pranuar ndërkombëtarisht nga STANAG 6001 standarde të NATO-s në nivelin përkatës, ku nëpunësit administrativë nga kategoria V duhet të posedojnë certifikatë me STANAG 1+1+1+1+

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 19.708,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2017 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

5. UPR 01 01 V04 000 Bashkpunëtor i ri 1 realizues(ë)
për sigurim të dokumentimit teknik dhe të
tjera për furnizime publike, Njësia për
kontabilitet dhe pagesa, Sektori për
çështje financiare

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1 - Shkencat Ekonomike, Juridike ose Administratë publike
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombtarisht e të lëshuar nga

testatorët oficialë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve evropianë të nivelit A2 të CEFR, përkatësisht KET, IELTS me 3 pikë maksimum, BULATS, ose TOEFL PBT së paku 400 pikë, TOEFL CBT së paku 95 pikë, ose TOEFL IBT së paku 30 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose certifikatë Gete.

Njohja e gjuhës angleze mund të dëshmohej edhe me dorëzim të certifikatës së pranuar ndërkombëtarisht nga STANAG 6001 standarde të NATO-s në nivelin përkatës, ku nëpunësit administrativë nga kategoria V duhet të posedojnë certifikatë me STANAG 1+1+1+1+

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 19.708,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2017 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

6. UPR 01 01 V04 000 Bashkëpunëtor i ri 1 realizues(ë) për punë normative juridike nga sfera e planifikimit urbanistik, Njësia për urbanizëm dhe planifikim hapësinor, Sektori për urbanizëm dhe planifikim hapësinor, zhvillim ekonomik lokal dhe mbrojtje të mjedisit jetësor

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1 - Shkencat Juridike
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë

- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombëtarisht e të lëshuar nga testatorët oficialë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve evropianë të nivelit A2 të CEFR, përkatësisht KET, IELTS me 3 pikë maksimum, BULATS, ose TOEFL PBT së paku 400 pikë, TOEFL CBT së paku 95 pikë, ose TOEFL IBT së paku 30 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose certifikatë Gete.

Njohja e gjuhës angleze mund të dëshmohej edhe me dorëzim të certifikatës së pranuar ndërkombëtarisht nga STANAG 6001 standarde të NATO-s në nivelin përkatës, ku nëpunësit administrativë nga kategoria V duhet të posedojnë certifikatë me STANAG 1+1+1+1+

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 19.708,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2017 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

7. INS 01 01 V01 001 Këshilltar - 2 realizues(ë) Inspektor i autorizuar i ndërimitarisë, Njësia për mbikëqyrje inspektoriale - Inspektorat Komunal

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallën VII/1 - Arkitekturë, urbanizëm dhe planifikim ose ndërimitari dhe ekonomizim të ujërave
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë

- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombëtarisht e të lëshuar nga testatorët oficialë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve evropianë të nivelit A2 të CEFR, përkatësisht KET, IELTS me 3 pikë maksimum, BULATS, ose TOEFL PBT së paku 400 pikë, TOEFL CBT së paku 95 pikë, ose TOEFL IBT së paku 30 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose certifikatë Gete.

Njohja e gjuhës angleze mund të dëshmohej edhe me dorëzim të certifikatës së pranuar ndërkombëtarisht nga STANAG 6001 standarde të NATO-s në nivelin përkatës, ku nëpunësit administrativë nga kategoria V duhet të posedojnë certifikatë me STANAG 1+1+1+1+

Kushtet shtesë:

- Licencë, leje për kryerje të mbikëqyrjes inspektoriale

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 25.865,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2017 janë të parapara: Shqiptar(e) 2.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Faza e 4 – të: Testi i personalitetit realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të fazës së 3 – të.

Në bazë të nenit 31 të Statutit të Ndërmarrjes publike Rrugë dhe rrugica – Shkup, Vendimit nr. 02-4771/1 prej 27.07.2017 për nevojën për punëtor për themelimit të marrëdhënies së punës, Rregulloren për sistematizimin të vendeve të punës në ndërmarrje dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, drejtori publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Ndërmarrja publike Rrugë dhe rrugica – Shkup ka nevojë për themelimit të marrëdhënies së punës për kohë të pacaktuar me punëtor për vendet e punës në vijim:

A. 10 (dhjetë) punëtorë për vendin e punës – Punëtor i PKU

(për pastrim të kanaleve të hapura në rajonin e qytetit të Shkupit në pjesën urbane të qytetit dhe për ngjitje me fugonit)

Me arsim fillor të mbaruar me ose pa përvojë pune

Paga bazë për vendin e punës është 12.495,00 denarë.

-Marrëdhënia e punës themelohet me orar të plotë të punës, me orar javor të rregullt të punës prej 40 orëve;

-Orari ditor i punës fillon prej ora 07:00 deri në ora 15:00

Të gjithë kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:

- Fletëparaqitje me biografi të shkurtë (CV)

- Kopje të letërnjoftimit

- Dëshmi për arsimin e mbaruar përkatës

-Dëshmi për përvojën e punës në profesion nëse posedon

Kandidatët e interesuar, fletëparaqitjen së bashku me dëshmitë për plotësimin e kushteve të posaçme, sipas kësaj shpallje mund ti dorëzojnë në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e publikimit të shpalljes (duke mos konsideruar ditën e publikimit) drejtpërdrejtë në arkiv të Ndërmarrjes publike të rrugëve – Shkup, rr. Kole Nedelkovski nr. 38, 1000 Shkup ose përmes postës, tel. për kontakt 02/3162 317, personi për kontakt Marina Davçevska.

Ndërmarrja publike e rrugëve – Shkup, zgjedhjen do ta realizojë në afat prej 45 (dyzetepesë) ditëve të punës, pas kalimit të afatit për paraqitje, ndërsa nëse ka më shumë se 200 të paraqitur zgjedhja do të realizohet në pajtim me afatet e caktuara ligjore.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

NP rrugë dhe rrugica – Shkup



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16 dhe 142/16“) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 90/15“), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14 dhe 27/16“) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimin të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrimit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 34/15“), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 27/2017

për punësimin e 1 nëpunësve publik nga grupi I, nëngrupi II në „Ndërmarrjen Publike të Menaxhimit me Tregje me Shumicë dhe Pakicë "Tregu i Qytetit" - Ohër "për vendet e punës në vijim:

1. KDR 0101 V03 023 Bashkëpunëtor i burimeve njerëzore, Njësia e burimeve njerëzore, 1 realizues(ë) punëve të përgjithshme dhe administrative, Sektori i burimeve njerëzore, punëve të përgjithshme dhe administrative

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1 - Shkencat Juridike, Shkencat e Organizimit dhe udhëheqje (menaxhim)
- së paku 1 (një) vit përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombëtarisht e të lëshuar nga testatorët oficialë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve evropianë të nivelit A2 të CEFR, përkatësisht KET, IELTS me 3 pikë maksimum, BULATS, ose TOEFL PBT së paku 400 pikë, TOEFL CBT së paku 95 pikë, ose TOEFL IBT së paku 30 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose certifikatë Gete.
- njohja e gjuhës angleze mund të dëshmohej edhe me dorëzim të certifikatës së pranuar ndërkombëtarisht nga STANAG 6001 standarde të NATO-s në nivelin përkatës, ku nëpunësit administrativë nga kategoria V duhet të posedojnë certifikatë me STANAG 1+1+1+1+

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:00 - 15:00

Rroga neto: 20.001,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2017 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Faza e 4 – të: Testi i personalitetit realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të fazës së 3 – të.



Veton SURROI

Dhe tash, seriozisht?

-Rreth paralajmërimit të presidentit Vuçiq për zgjidhjen përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë.

1. Me shkrimin e fundit të presidentit Vuçiq, kjo bëhet hera e tretë brenda njëzet vjetësh që dëgjojmë nga prijësit e Serbisë nevojën që të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme, pra e përhershme, për marrëdhëniet mes Kosovës e Serbisë. Herën e parë, pas pothuajse një dhjetëvjetëshi dhune ndaj qytetarëve të Kosovës, e tha Slobodan Milosheviqi, ndonëse me formulimin se duhet gjetur zgjidhjen brenda Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë, kur dështuan të gjitha përpjekjet për gjetjen e "zgjidhjeve praktike që do të lehtësonin jetën e qytetarëve", sikur ishte Marrëveshja e dështuar për Arsim e San Egidios (ku u shpenzuan pesë vjet), Milosheviqi pranoi se duhej gjetur një "zgjidhje të gjithëmbarshme". Atëherë kishte filluar tashmë lufta dhe jo pak prijës ndërkombëtarë deklarorin se ndoshta kësaj here duhej biseduar me Milosheviqin me gjuhën e vetme që e kupton, forcën. Nuk u gjet një "zgjidhje e gjithëmbarshme" që, me gjithë shumë kompromise nga ana e delegacionit të Kosovës, të kënaqte vizionin e Milosheviqit për një zgjidhje të gjithëmbarshme. Zgjidhja në Rambouillet e përjashtonte shtetin e Serbisë nga Kosova pas tre vjetësh, dhe një gjë e tillë nuk ishte e kënaqshme për Milosheviqin. Pas çlirimit të Kosovës, herën e dytë u tha nga kryeministri Gjingjqi. For-

mulimi i tij ishte më i thjeshtë se i Milosheviqit dhe përmblidhej pak a shumë në kërkesën që Serbia të marrë një copë territori të Kosovës të banuar me serbë dhe të mos çajë më kokën me Kosovën. Kryeministri Gjingjqi nuk arriti ta formulojë në hollësi planin e tij për ndarjen e Kosovës, sepse u vra nga një snajperist, serb i Pejës, që kishte ushtruar gjuajtje në mish të gjallë kroatësh, myslimanësh e shqiptarësh si pjesëtarë i njësiteve speciale të Arkanit, rrjedhimisht të shtetit të Serbisë.

Paralajmërimi i presidentit Vuçiq, që i ka fillesat e një platforme, vë theksin tek një pikë që nuk është bërë deri më tani - zgjidhjen e përhershme të konfliktit, një që nuk bëhet me insistimin qorr tek suazat e "Autonomisë së Kosmetit" e as një që do të vendosë me të shpejtë kufirin e ri etnik mes shqiptarëve e serbëve. Pra, nëse do vlerësuar me një fjali se çfarë është porosia e letrës së Vuçiqit atëherë është "e tash, seriozisht", do të thotë se tash më në fund Serbia duhet të ulet dhe të arrijë një marrëveshje të përhershme me Kosovën.

2. Platforma "e tash, seriozisht" ka potencial të madh pozitiv. Fillimisht ngase është shprehje kul-

more pas përpjekjeve të pamjaftueshme apo të dështuara për të trajtuar marrëdhëniet e Kosovës me Serbinë - gjegjësisht konfliktin e pambaruar mes Kosovës dhe Serbisë - rrjedhimisht theksim i nevojës që të arrihet një paqe e qëndrueshme në regjion. Pastaj, është e një rëndësie të madhe ngase vjen në një moment kur presidenti Vuçiq përfaqëson shumicën dërrmuese të vullnetit politik të Serbisë. Një gjendje e këtillë, sa i përket vullnetit politik, ka ekzistuar me Milosheviqin, por dallimi është në lavjerrësi ekstremizmas karshi serbëve. Në të përfunduar lufta, u organizua një fushatë e debimit të serbëve nga disa vise të Kosovës - herë pse ishin serbë, herë pse kishin prona, herë për të dyja shkaqet së bashku. Më 2004, po ashtu, u krijua një dhunë e organizuar ndaj serbëve, që herë kishte qëllim shfryrjen e pakënaqësive e herë krijimin e tregut të lirë të patundshmërive, siç është rasti me Çagllavicën. Në anën tjetër të lavjerrësit, përfaqësuesit e shumicës shqiptare bënë kompromise edhe pa negociatën. Në Kornizën kushtetuese (që më vonë u bë Kushtetutë) pranuar që serbët të jenë detyrimisht pjesë e Qeverisë - dhe Kosova kështu u bë vendi unikat ku kualifikimi i vetëm i nevojshëm për ministër është përkatësia etnike, serbe. Dhe pa filluar negociatat u krijua parimi etnik i decentralizimit, me formimin e komunave të reja serbe (në mënyrë që

koha të definohej se çka është me të vërtetë interesi serb jashtë formulës së dështuar të dominimit.

3. Por, platforma "e tash, seriozisht" do të jetë sfiduese së paku në dy pika madhore.

E para pikë është të realiteti i ndërlikuar juridik e politik që është krijuar në jetë e negociatën e që, siç shihet, ishin pjesë e platformës "nuk e kemi seriozisht". Prej vitit 1999 e këtej, përfaqësuesit e shumicës shqiptare janë angazhuar në veprime të një lavjerrësi ekstremizmas karshi serbëve. Në të përfunduar lufta, u organizua një fushatë e debimit të serbëve nga disa vise të Kosovës - herë pse ishin serbë, herë pse kishin prona, herë për të dyja shkaqet së bashku. Më 2004, po ashtu, u krijua një dhunë e organizuar ndaj serbëve, që herë kishte qëllim shfryrjen e pakënaqësive e herë krijimin e tregut të lirë të patundshmërive, siç është rasti me Çagllavicën. Në anën tjetër të lavjerrësit, përfaqësuesit e shumicës shqiptare bënë kompromise edhe pa negociatën. Në Kornizën kushtetuese (që më vonë u bë Kushtetutë) pranuar që serbët të jenë detyrimisht pjesë e Qeverisë - dhe Kosova kështu u bë vendi unikat ku kualifikimi i vetëm i nevojshëm për ministër është përkatësia etnike, serbe. Dhe pa filluar negociatat u krijua parimi etnik i decentralizimit, me formimin e komunave të reja serbe (në mënyrë që

pas disa vjetëve të kërkohej centralizimi etnik, pra grupimi i komunave serbe).

Prej se filluan negociatat me platformën "nuk e kemi seriozisht", përfaqësuesit e Kosovës jo vetëm se kanë pranuar parimin se Serbia do ta ketë fjalën e vet prej hisedari në Kosovë, por pranuan një zgjidhje të re të pushtetit të tretë, me Bashkësinë e Komunave Serbe, që u ndal nga protestat e opozitës së atëhershme dhe falë tyre edhe nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Në këto njëzet vjet që Serbia nuk e ka pasur seriozisht, Kosova ka bërë lëshime në strukturën e vet shtetërore deri në kufijtë ekstrem të funksionalitetit. Dhe sfida që paraqitet në momentin kur Serbia "e ka seriozisht" është se çka të bëhet me tërë ato koncesione të bëra deri tani? Sepse, nuk do mend, çfarëdo negociatë e ardhshme prapë do të kërkojë që, siç thotë dhe vetë presidenti serb, të bëhen kompromise.

4. Pika e dytë sfiduese do të jenë përfaqësuesit e shumicës në Kosovë. Prej vitit 2008 e këtej, nga shpallja e pavarësisë janë angazhuar në një proces të gabuar (të pamjaftueshëm, të dëmshëm, të pamenduar mirë - çfarëdo që të jetë cilësimi). Kanë shpenzuar kohë, vullnet, para e përkrahje ndërkombëtare për një projekt i cili u ndërtua si mohim urgjent i Serbisë ndaj mendimit të Gjykatës ndërkombëtare të Drejtë-

sisë se shpallja e Pavarësisë së Kosovës është brenda së drejtës ndërkombëtare. Tash, kur Serbia "e ka seriozisht", Kosova zyrtare nuk mund të silltet sikur fëmija në lojë e të thotë "e, tash unë nuk dua". Këtë nuk mund ta bëjë ngase deri më sot nuk i ka shpjeguar as vetes e as të tjerëve se në çfarë procesi joserioz ka qenë e përfshirë. Por, madje edhe po ta kishte bërë, gjithsesi është interes i Kosovës që të hyjë në një proces ku vihet në tryezë i tërë spektri i problemeve të hapura me Serbinë. Për ta bërë këtë, Prishtina zyrtare duhet të ulet dhe të analizojë veprimet e veta, së paku nga çlirimi deri më sot, të konstatojë dështimet dhe të krijojë një platformë të re. Platforma e re duhet të strukturojë të tri rrafshet e problemeve që Kosova ka me Serbinë: të kaluarën (pasoja e okupimit dhe të luftës), të tanishmen (sulmin konsistent ndaj funksionimit të shtetit të Kosovës dhe përfaqësimit të tij ndërkombëtar) dhe të ardhmen (integrimin në hapësirën Atlantike dhe në atë Evropiane). Alternativa ndaj këtij lloj strukturimi është procesi pesëvjeçar i "letërngjitësit", të debatit të kotë mbi targar automobilistike. Dhe, natyrisht, platforma e re ka dy parakushte: njerëz të rinj dhe përkrahje të dukshme të shumica shqiptare.

5. Ftesa e presidentit serb, për një veprim "e tash, seriozisht" ndoshta mund të ketë efekt pozitiv edhe te bashkësia ndërkombëtare. Bashkimi Evropian dhe SHBA-ja mund të kontribuojnë shumë në një proces të ri negociator. Posaçërisht nëse vendosin edhe vetë të jenë të përfshira "tash, seriozisht". (koha.net)



Edlira GJONI

Ja si ndikon media në rritjen e numrit të vetëvrasjeve

"Gjuha e përdorur nga media është shumë shqetësuese. Çdo vrasje shitet si sensacion, përshkruhet me fjalë të mëdha dhe tekstet janë mbushur me figura letrare, që depërtojnë njëra lehtë te lexuesit. Për një mori arsyesh, konsumatorët e medias ndikohen nga metaforat, krahasimet e hiperbolat që ndeshen rëndom në median shqiptare, e cila e transmeton vrasjen e vetëvrasjen si trumbetimin e ditës

Për një mori arsyesh, konsumatorët e medias ndikohen nga metaforat, krahasimet e hiperbolat që ndeshen rëndom në median shqiptare, e cila e transmeton vrasjen e vetëvrasjen si trumbetimin e ditës

shkurta, të shpeshta e tejet sipërfaqësore ka bërë që vrasjet e vetë-vrasjet të shiten si sensacion titujsh, sepse kaq arrijnë të marrin

e të kuptojnë nga gazetaret dhe nga mediat e mëdha. Për pasojë, kemi sekuenca të tëra që pasojnë çdo vetëvrasje, me detaje të panevojshme që shpjegojnë si ndodh një ngjarje, ku ishte i vetë-dëmtuari, ku u gjet, kush e gjeti, çfarë tha kur e pa, si reagoi fqinj, ç'mendon ndjekësija e tij në Instagram, e të tjera detaje të panevojshme si këto, që në vend që të sqarojnë kontekstin e vërtetë përse ndodh ngjarja, ndikojnë negativisht në përsëritjen e saj. Shifrat tregojnë se ng-

jarjet imitohen saktësisht siç shihen në media nga 3-7 ditë pas çdo ngjarje, interval ky që mbart edhe rrezikun më të madh të përsëritjes së aktit, ku në mënyrë të pavullnetshme, median luan rol nxitës. Detajet më ndikuese të medias janë: gjuha sensoriale, titujt e bujshëm, përshkrimi i vendit të ngjarjes, detajet e panevojshme rreth aktit, shmangia e zërit të ekspertëve për ngjarjet e përsëritura, mungesa e thellësisë së analizës për kontekstin psiko-social ku ndodh ng-

jarja, trajtimi i çdo rasti si individual, ndërkohë që vetë-vrasja është kthyer në fenomen të frikshëm. Media sociale ndikon gjithashtu negativisht me pasqyrimin e nxituar të detajeve rreth ngjarjes, që më pas rrëzohen, por ndërkohë dëmin e bëjnë. Ndodh rëndom që volumi i raportimeve të jetë i lartë në ditën që ndodhin vrasjet dhe zbehet nga 3-7 ditë më pas.

Ndodh që ngjarjet e ngjashme të përsëriten në po këtë interval. Shumë studiues mendojnë se kjo është

pasoje e drejtpërdrejtë e mënyrës se si media raporton vetëvrasjet. Prandaj, më shumë kujdes duhet treguar se si raportohet ngjarja, sa thellë, kush citohet, si verifikohet dhe cili stad i ngjarjes raportohet. Megjithatë, ky është hap që mund ta luajë vetëm media tradicionale, televizionet dhe gazetaret e mëdha. Fatkeqësisht, mediat dhe rrjetet sociale nuk e bëjnë dot këtë ndryshim, prandaj kujdesin e dyfishtë duhet ta luajnë lojtarët e mëdhenj mediatikë në treg". (shekulli)

shtojcë enigmatike e fundjavës

SKANDI hualli

1

POLITIKANI YNE, TAHIRI

2

POLITIKANI SRI LANKAN, PERERA (. E.O. AL)

QYTET NË RUMANI

SPECIALITET JAPONËZ ME ORIZ E PESHK (SH.)

ATËVIT

VEGËL MUZIKORE POPULLORE

DRU HALOR, QIPARISI

LLOJ KËRPUDE OË RRRITË NË AFRIKË (S.L.L.S)

KUKULLA SHËTITËSE, MONGGO (. T. . RI)

AKTORI DHE KËNGËTARI, ASLLANI

BANOR I QYTETIT NË FOTO

POETI NË LA (SHQ.)

MUZIKANTJA JAPONËZE, UEHARA (H. . O. .)

PROVINÇË NË EKUADOR (. O. . N.)

AKTORJA ITALIANE, ANA

OË KA TË BËJË ME VALET (SH. PASHO)

PORTE

BIOLOGU ITALIAN, SPALLANZANI (L. Z. R.)

GRUPI ANGLEZ STOUNS

BEIZBOLLIST I SAN FRANCISKOS (R. B. N. N)

DERIVAT I NAFTËS

LUMË NË ZAMBI

3

I LËNDUAR, I FYER, I NJOLLOSUR, I...

EMRI I VJETËR I QYTETIT NË FOTO

PEMË TROPIKALE

RAJON MIDIS DETIT TË ZI DHE LIQENIT KASPIK

TË DHËNAT E VENDBANIMIT

BANOR I ADANASË

4

Kakuro

e lehtë

			7	17		
		10				
					24	
	16	6				16
13					17	
				6		
8				19		
			17			
	11					
		11				

mesatare

		13	14			
15						
				21		15
20					16	
					19	
			18			
17	9					
25						3
					17	
16				17		
				9		

e vështirë

						4	17
						11	
		4	29	11			
	20						
		11					
						4	
			14				
	17	3					
23							
10							

Sudoku

i lehtë

	9		6					5
6		1					9	7
7				8				4
		9	4		5			
	4							1
			8		3	4		
2				6				5
3		6				7		2
	5			2		3		


mesatar

	8		6	5				7
3			9			4		
9	7					8		6
	1							
6		3	8		1			
4				3				
			7	5				1
								3
5			4			7		2

i vështirë

	6							4
		2		9	3			
3	9	4	7			2	5	1
	2			9		4		
			3		2			
	7		5					3
2	4	6			1	5	9	3
		9	5			1		
	3							2

MENSUR MAMUTI	INJEKSIONI	KALLI MISRI PËR FARË QË VARET NË TRA	MJESHTRI HOLANDEZ I SHAHUT, TIMAN	NGADHNJIM NDRYSHIMI I ZËRIT NË MELODI	F	PËRSHKRIM I NDËRTIMIT TË TREGIMIT VËND NË VOJVODINE	S	LITER	BASHKIM PAÇUKU	HARKU QIELLOR ME NGJYRAT E SPEKTRIT	VEPËR E N.M. MBRETI I SHEKSPIRIT	L	VIGAN, KOLOS
VEPËR E N.M.													
EPËRSI, NË PËRPËRESI								KËSULA JONË TRADICIONALE ZE					
NDARJET TERRITORIALE NË ZVICËR									SENATORI I PERANDORISË ROMAKE R.D.				
STRONCI			GOJËTARE QË NUK ZBËRTHËHET, JOSINTETIKE								NDAJFOLJE SASIE ENERGJI		
IMPULS		AKTORJA AMERIKANE, BENING "... IACTA EST" (maksime latine)						EMRI (SHIH FOTON) MBIEMRI (SHIH FOTON)				AZOT	
ADM. KOMB. AERONAUTIKE HAPËSINORE AMERIKANE SHOTE					PËREMËR PRONOR A.SH.								
G								JANAR PERSONAZHI ZEQO (Luan Daka)					
KOHA E LIRË	DHËNËR VEPËR E N.M.												
ISH FUTBOLL. POLAK, GZHEGOZH						ADEM DEMAÇI AKTORI PETROVCI							
ITALI		KENGETARJA TARIFA FILOZOFI GJERMAN HEKEL											
RRJETËZA E SYRIT										VETURË E VJETËR ANGLEZE E VITEVE TË '30			
I PAPËR-DORUR ORGAN TRETËS					VOLT SHKALLA E MATJES SË TËRMETIT		ANGSTREM AUSTRI						
P													
KOHA E LIRË	SODITJE, SEHIR SHKRIMTARI HATIPI						TEMPO LLOJ GURI TË ÇMUAR (shq.)		TAUTOLOGJI	BAGREM	HAPËSIRË PROMOVIMI NË PANAIR (sh.pashq.)	S	KAMPIONJA MË E MIRA AKTORI STIVEN MAL NË KROACI E BOSNJE
TINA TARNER		"HOSPITAL" FIRMË E NJOHUR KOZMETIKE			AKTORJA KOSOVARE DOBROSHI KRYENEÇËSI						FILM I ROMAN POLANSKIT (luan Nastja Kinski RUMANI)		
SHKRONJA E PARË		KRAHINË GREKE PËREMËR VETOR						LLOJ PESHKU J.S.					
VEPËR E N.M.											NUMERICAL ALGORITHMS GROUP O.D.		
VEHJE ESKIMEZE								VEPËR E N.M. REZE					
I PRISHUR, QË BIE COPE, KALBUR									I PËRKRYER				



8	2	1	3	5	6	9	4	7	4
4	9	1	2	3	6	7	8	5	3
3	6	5	7	1	4	2	8	9	6
4	1	7	8	9	6	5	3	2	7
6	5	8	4	2	1	7	9	3	8
9	5	8	3	4	7	6	2	1	5
2	3	6	7	9	4	8	5	1	3
5	8	2	4	1	9	3	7	6	4
7	6	1	2	3	5	8	4	9	7

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	56	57	58	59	60	61	62	63	64	65	66	67	68	69	70	71	72	73	74	75	76	77	78	79	80	81	82	83	84	85	86	87	88	89	90	91	92	93	94	95	96	97	98	99	100
---	---	---	---	---	---	---	---	---	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	-----

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	56	57	58	59	60	61	62	63	64	65	66	67	68	69	70	71	72	73	74	75	76	77	78	79	80	81	82	83	84	85	86	87	88	89	90	91	92	93	94	95	96	97	98	99	100
---	---	---	---	---	---	---	---	---	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	-----

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	56	57	58	59	60	61	62	63	64	65	66	67	68	69	70	71	72	73	74	75	76	77	78	79	80	81	82	83	84	85	86	87	88	89	90	91	92	93	94	95	96	97	98	99	100
---	---	---	---	---	---	---	---	---	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	-----

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	56	57	58	59	60	61	62	63	64	65	66	67	68	69	70	71	72	73	74	75	76	77	78	79	80	81	82	83	84	85	86	87	88	89	90	91	92	93	94	95	96	97	98	99	100
---	---	---	---	---	---	---	---	---	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	-----

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	56	57	58	59	60	61	62	63	64	65	66	67	68	69	70	71	72	73	74	75	76	77	78	79	80	81	82	83	84	85	86	87	88	89	90	91	92	93	94	95	96	97	98	99	100
---	---	---	---	---	---	---	---	---	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	-----

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	56	57	58	59	60	61	62	63	64	65	66	67	68	69	70	71	72	73	74	75	76	77	78	79	80	81	82	83	84	85	86	87	88	89	90	91	92	93	94	95	96	97	98	99	100
---	---	---	---	---	---	---	---	---	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	-----

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	56	57	58	59	60	61	62	63	64	65	66	67	68	69	70	71	72	73	74	75	76	77	78	79	80	81	82	83	84	85	86	87	88	89	90	91	92	93	94	95	96	97	98	99	100
---	---	---	---	---	---	---	---	---	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	-----

5	6	9	1	3	4	8	9	7	2
7	4	2	1	9	6	5	8	3	4
8	3	9	7	5	2	6	4	1	8
4	5	7	2	3	9	1	6	8	5
6	9	3	8	7	1	2	5	4	3
2	1	8	5	6	4	7	3	9	8
9	7	5	4	1	3	8	2	6	7
3	8	2	6	9	8	7	4	1	5
1	8	4	6	2	5	3	9	7	1

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	56	57	58	59	60	61	62	63	64	65	66	67	68	69	70	71	72	73	74	75	76	77	78	79	80	81	82	83	84	85	86	87	88	89	90	91	92	93	94	95	96	97	98	99	100
---	---	---	---	---	---	---	---	---	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	-----

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	56	57	58	59	60	61	62	63	64	65	66	67	68	69	70	71	72	73	74	75	76	77	78	79	80	81	82	83	84	85	86	87	88	89	90	91	92	93	94	95	96	97	98	99	100
---	---	---	---	---	---	---	---	---	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	-----

NUMRA DHE SHKRONJA: 6+5=11, 7+4=11, 11x11=121, 121+3=124,



Gazi helmues dhe lëndë të tjera kimike u përdorën me dhjetëra herë gjatë konfliktit në Bosnjë për të torturuar dhe vrarë të burgosurit, por pothuajse asnjë s'është shpallur në mënyrë direkte përgjegjës në gjykatë

Xhana BËRKANIÇ

Në mbrëmjen e 24 korrikut 1992, të burgosurit që mbaheshin në një dhomë në kampin e paraburgimit në Keraterm afër Prijedorit filluan të kishin halucinacione dhe të sillleshin çuditshëm. "Filluam të këndonim dhe më vonë filluam të ziheshim me njëri-tjetrin," kujton njëri prej tyre, i cili donte të identifikohet vetëm me inicialet M.N. M.N. beson se "atë natë në dhomë u hodh një helm nervor" – preludi për një masakër. Jashtë dhomës, rojet po përgatiteshin për të vrarë.

"Ata vendosën një armë në oborr dhe na qëlluan nga dera. Shumica prej nesh vdiqën nga helmi dhe jo nga plumbat. Dy xhaxhallarët e mi vdiqën nga helmi, jo nga plumbat kudo kishite fqinjë dhe miq të mi që ishin plagosur," tha M.N.

Përdorimi i gazit helmues ishte i ndaluar nga një konventë ndërkombëtare për trajtimin e civilëve dhe të burgosurve të luftës. Një protokoll i frymëzuar nga vrasjet e shaktuara nga armët kimike gjatë Luftës së Parë Botërore, por dëshmitarët kanë raportuar dhjetëra shembuj të përdorimit të tij gjatë luftës në Bosnjë 1992-1995. Në më shumë se 800 raste krimesh lufte të dëgjura nga Gjykata e Hagës dhe gjykatat në ish-Jugosllavi, përdorimi i gazit helmues dhe armëve të tjera kimike është përmendur vetëm me raste, më shpesh si një nga metodat e abuzimit në kampet e paraburgimit. Zyra e Prokurorit të Shtetit në Bosnjë tha për BIRN se aktualisht nuk ka hetime në lidhje me përdorimin e helmeve apo lëndëve kimike në luftë. Por helme të tilla janë vërtetuar se

Lufta në Bosnje

Gazi helmues, arma e harruar



janë vdekjeprurëse, sipas dëshmitarëve okularë, dhe ekspertë mjekësor besojnë se ato mund të shkaktojnë gjithashtu probleme shëndetësore apo mendore për shumë vite më pas.

"Filluam të mbyteshim"

Gaz lotsjellës dhe tymëse u hodhën në një konvikt studentësh në Bileca, ku të burgosurit boshnjakë të luftës u burgosën në vitin 1992, sipas deklaratave të të mbijetuarve.

"Nuk e dinim se çfarë ishte. Kur filluam të mbyteshim, e kuptuam që ishte helm," kujton një prej tyre, Zeljko Bajramović.

Vendimi i Gjykatës së Hagës në rastin e ish-zyrtarëve të policisë serbe të Bosnjës Mico Stanisiç dhe Stojan Zupljanin – të cilët u dënuan me një total prej 44 vitesh burg – citon se në korridore dhe tre nga dhomat u hodhën bomba gazi. Një dëshmitar u zgjua kur dëgjoi një zhurmë të lehtë dhe dikë që bërtiti: "Helm".

"Gazi po bënte që të

gjithë të qanin, mbyteshin, villnin dhe të kishin irritim sysh. Ditën tjetër, një i paraburgosur i quajtur Sajto Bajramović po urinonte gjak dhe kishte kriza," thuhej në vendimin e gjykatës. I njëjti vendim thotë se rojet serbe hodhën dy bomba gazi helmues në një bodrum në Podlugovi, ku mbaheshin të burgosur civilë boshnjakë dhe kroatë, duke u shaktuar vuajtje të rënda mendore dhe fizike të burgosurve. Disa u sëmurën dhe njëri vdiq.

"Dëshmitari i mbrojtur ST-004 deklaroi në dëshminë e tij se i digjte fyti. Të ndaluarit arritën ta thyenin derën dhe të dilnin nga bodrumi," thuhej në vendim.

Disa dëshmitarë dëshmuar në gjyqe në Hagë dhe në Bosnje dhe Hercegovinë se forcat serbe hodhën lëndë kimike në trupat e njerëzve të vrarë në Koricanske Stijene në vitin 1992 në përpjekje për të fshehur krimin. Në gjyqin në Sarajevë të ish-drejtorit të burgut Branko Vlaço, i cili u dënua me 15 vjet

burg për krime kundër njerëzimit për abuzimin e të burgosurve jo serbë në kampet e paraburgimit në vitin 1992, një dëshmitar tha se në dhomën e një të burgosuri, ku ai u mbajt verën e vitit 1992, në burgun Bunker në Vogosca ishte hedhur gaz lotsjellës. "Të lotonin sytë, teshtije dhe qaje," tha dëshmitari Armin Balesiç.

Një plan sistematik?

Ka këndvështrime të ndryshme mbi faktin nëse përdorimi i gazrave helmues nga forcat serbe gjatë konfliktit në Bosnjë ishte pjesë e një plani më të gjerë apo u krye nga elementë mashtrues. Psikologu Senadin Fadilpasiç beson se përdorimi i helmeve ishte pjesë e një plani më të gjerë për të shkatërruar popullsinë boshnjake.

"Padyshim që ka pasur një plan sistematik dhe qëllimi ishte shkatërrimi, dhe kishte një strategji për të trajtuar të burgosurit në atë mënyrë për të arritur këtë qëllim," tha Fadilpasiç.

Megjithatë, sociologu Srdjan Puhalo beson se vetëm "psikopatët" përdorën armët e tilla kimike dhe se nuk ishte "një përdorimi sistematik dhe të planifikuar".

"Më duket sikur disa psikopatë e gjetën atë "gjë" dhe atëherë thanë "Le të argëtohem pak – tani kemi gaz lotsjellës dhe le të shohim se çfarë ndodh nëse e hedhim," tha Puhalo.

"Këta njerëz janë ndoshta të njëjtë që vranë, rrahën dhe përdhunuan," sugjeroi ai.

Ish i ndaluar Samir Pojskiç është dakord se ata që përdorën gaz helmues ishin rojat më brutale të kampeve të burgimit të kohës së luftës.

"Ka të bëjë me mbeturinat njerëzore të para kohës së luftës, shumica e këtyre rojave kishin një lloj frustrimi në jetë," tha Pojskiç.

"Unë e quaj sadizëm, sepse metodat që përdorën ata janë përtej edhe nevojave më të rënda njerëzore. Pra, nuk është e habitshme që ata përdorën çdo

mjet për të poshtëruar më shumë të burgosurit dhe për t'i zhvlerësuar të burgosurit si genie njerëzore dhe pastaj për t'i shkatërruar ata," shtoi ai.

Megjithatë, psikologja Ivanka Jakovaç tha se beson se disa luftëtarë përdorën gaz helmues thjesht se u urdhëruan ta bënin këtë.

"Nëse nuk i zbatonin ato urdhra, do të vriteshin ose ndëshkoheshin. Dhe komandantët, ata janë njerëzit që që kanë sëmundje mendore," u shpreh Jakovaç.

Pasoja të përhershme

Sudbin Musić, një ish i ndaluar në kampin Omarska pranë Prijedorit, këmbënguli se përdorimi i gazit helmues ishte "thjesht një tjetër në një seri torturash" që kryeshin nga rojet. Doktorët thonë se shumë ish të burgosur kanë ende probleme shëndetësore kronike për shkak të ekspozimit ndaj helmeve kimike, si dhe vuajnë pasojat psikologjike të kësaj.

"Çdo vuajtje, traumë dhe frikë lë pasojë afatgjatë," tha Jakovaç.

Neuropsikiatri Abdulah Kucukaliç tha se pasojat për shëndetin e ish të burgosurve varen nga lloji i helmit që është përdorur – helmet nervore prekin trurin, ndërsa të tjerë lloje prekin gjakun, mëllçinë, zemrën ose organe të tjera. "Kur vjen puna te toksinat nervore që prekin trurin dhe ndryshojnë sjellje, sigurisht që kjo sjell pasojë jo vetëm të përkohshme, por edhe të përhershme për shëndetin mendor të dikujt dhe shpesh shkaktojnë vdekje," shpjegoi Kucukaliç. Ai tha se viktimat mund të vuajnë halucinacione që zgjasin dhe vizione dhe çrregullime perceptimi. Njëzet e dy vjet pas përfundimit të luftës, ish të burgosurit po bëjnë thirrje që të zhvillohet një studim cilësor për ndikimin në shëndetin e njerëzve të ekspozuar ndaj helmeve dhe lëndëve të tjera kimike që janë përdorur gjatë luftës dhe që prokurorët të hapin hetime. (birn)

Predrag Marković, historian serb

Duhet thënë e vërteta për Kosovën

Besoj se presidenti serb, Aleksandar Vučić, ka ndërmarrë një vendim dhe vlerësim të mençur prej burrështetasi që "fjalën më të shtrenjtë serbe" dhe "çështjen më të shtrenjtë serbe" nuk mund ta zgjidh vetëm një kokë, qoftë ajo edhe më e mençura.

Kështu ka thënë për "Tanjugun" serb, historiani dhe nënpresidenti i Partisë Socialiste të Serbisë (SPS), Predrag Marković, në lidhje me thirrjen e presidentit serb për një dialog të gjerë shoqëror për çështjen e Kosovës. Thirrjen e Vučićit, Marković e sheh si

dëshirë të tijën për të mbledhur të gjitha forcat mendore dhe politike të popullit serb, pasi që, siç thotë ai, çështja e Kosovës është unike në Evropë sepse asnjë shtet tjetër nuk ka problem të këtillë.

Sipas fjalëve të tij, asnjë shtet tjetër përpos Serbisë nuk ka përjetuar që në paqe "ish-aleatët e saj në Lufta Botërore t'i marrin pjesë të territorit dhe të bëjnë para-shtet pa asnjë referencë në të drejtën ndërkombëtare". "Për një problem kaq të pazakontë nevojiten natyrisht edhe zgjidhje të pazakonta.

Propozimet për zgjidhjen e çështjes së Kosovës



të nisura nga Dushan Bataković, Dobrica Qosiq, Dejan Despiqa i ka shkelë rrota e historisë. Na nevojiten zgjidhje të reja, të cilat në vete thonë se çfarë

në të vërtetë mund të realizojmë në Kosovë", thotë Marković. E kjo do të thotë, paralajmëron Marković, se ka ardhur koha që edhe ne të jemi të

ndershëm me vetveten, që ai dialog në shoqërinë tonë të mos reduktohet në fraza.

"Ato që priftërinjtë e Kishës ortodokse serbe i thonë për Kosovën, janë fraza. Këto propozime duhet të jenë të drejta. Perandori japonez dikur pati thënë shumë mirë se vjen një moment kur duroni të padurueshmen dhe vuani të pavuajtshmen. Këtë e ka thënë pas rënies së bombave atomike në Japoni. Kështu edhe ne duhet thënë të vërtetën zëshëm, cilado qoftë ajo dhe që i tërë opinioni të jetë i njoftuar", ka shtuar Marković.

Për të nuk ka asnjë dilemë se shumica e serbëve do të donin ta shihnin një Kosovë pa shqiptarë në shtetin serb. "Ne asnjëherë s'e kemi ditur se çfarë do të bëjmë me shqiptarët.

Në Kosovë ekziston një masë e madhe e popullit që urren shtetin tonë dhe kjo është si pasojë e atij ekuacioni në pazgjidhur nga e gjithë elita politike", thekson ai, transmeton. Historiani serb mendon se do të ishte mirë që të dilet në publik me propozime të ndryshme, të cilat nuk janë as fraza patriotike e as parulla demagogjike.



Të premtën në orët e para të mëngjesit është djegur vetura e Oliver Ivanoviçit, liderit të Iniciativës Qytetare SDP (subjekt politik i komunitetit serb në Kosovë), në pjesën veriore të Mitrovicës

Vendimin për anulimin e projektit për ndërtimin e Universitetit dhe Qendrës Kulturore në Mitrovicën veriore, e kanë sjellë institucionet e Bashkimit Evropian në Bruksel, dhe ky vendim nuk ka asnjë lidhje me revitalizimin e urës kryesore mbi lumen Ibër në Mitrovicë, ka deklaruar të enjten shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova

Bashkimi Evropian, javën e kaluar ka anuluar projektet me vlerë prej 7.8 milionë euro, për shkak se autoritetet komunale të Mitrovicës veriore nuk i kanë larguar objektet e ndërtuara në mënyrë ilegale, në afërsi të hapësirës ku do të duhej të fillonin ndërtimet, gjë që ishte e domosdoshme për qasje në zonat e ndërtimit. Gjatë një interviste me një grup të gazetarëve, Apostolova, ka thënë se kryetari i Komunës së Mitrovicës veriore, Goran Rakiq, paraprakisht kishte premtuar se do ta zgjidhë këtë çështje. Sipas saj, vendimi për anulimin të projekteve nuk ka qenë i lehtë dhe ai ka pasuar pas bisedimeve të rënda. Megjithatë, siç ka thënë Apostolova, BE-ja ka procedurë të caktuara, për më tepër kur bëhet fjalë për paratë e qytetarëve të Bashkimit Evropian. "E kuptuam që ekzistojnë probleme të caktuara që ndërlidhen me këto projekte. Për tetë muaj kemi komunikuar me administratën lokale në Mitrovicën veriore. Kushti i parë për fillimin e projektit është që të krijohet mundësia për qasje në vendin, gjë që është në përgjegjësinë e

Apostolova fajëson Mitrovicën e Veriut

Dështimi i projekteve në veri, për fajin e autoriteteve lokale



LISTA SRPSKA KËRKON GARANCI NË KËMBIM TË VOTËS

Lista Serbe ende nuk ka vendosur nëse do t'i votojë kandidatët e PAN-it për kryetar të Kuvendit dhe për kryeministër. Në këmbim të votës së tyre ata kërkojnë garanci që Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe do të themelohet. Asgjë nuk po flet në të mirë të koalicionit PAN. Përveç mungesës së numrave për t'i formuar institucionet PAN-i duket se do të ketë telashe të sigurojë edhe mbështetjen e "votave të sigurta" të minoriteteve, respektivisht ato të serbëve. Përfaqësues të Listës Serbe kanë njoftuar se ata ende nuk kanë vendosur nëse do të votojnë për kandidatët e PAN-it për kryeparlamentar dhe për kryeministër, shkruan "Zeri". Kjo ka lënë të kuptohet se Haradinaj dhe Veseli ende nuk kanë një marrëveshje përfundimtare me Listën Serbe, me ç'rast krijimi i institucioneve pa ta do të ishte i pamundur. Ndërkohë në ditën e dytë të regjistrimit të deputetëve të legjislaturës së gjashtë deputetët e koalicionit fitues të zgjedhjeve të 11 qershorit, PAN, kanë rikonfirmuar se institucionet do të bëhen shumë shpejt tani. Në anën tjetër, LVV-ja dhe LAA-ja përveçse thonë se nuk i kanë vota për PAN-in, ata kanë siguruar se nuk do ta votojnë as Veselin për kryeparlamentar nëse ai do të jetë i nominuar.

Komunës që ta zgjidhë. Kryetari i Komunës ka qenë i vetëdijshëm që kjo duhet të mundësohet në muajin prill. Fatkeqësisht, në rrugën dhe në afërsi të hapësirës ekzistojnë objekte jolegale, gjë që është në përgjegjësinë e Komunës që ta zgjidhë këtë". "Pas-

taj, pasoi komunikimi me kryetarin e Komunës dhe kolegët e tij, dhe të gjithë kanë qenë të informuar se çfarë duhet të bëjnë. Fatkeqësisht, asgjë nuk është ndërmarrë. Veprimi ynë i fundit, pas skadimit të afatit, ka qenë që ta sjellim zyrtaren e lartë nga Bruk-

seli që ta vizitojë Mitrovicën e veriut, e cila ia ka shpjeguar seriozitetin e situatës kryetarit të Komunës. Pas vazhdimit të afatit, përsëri nuk ka ndodhur asgjë. Ne ishim vënë në situatën që nuk kemi mundur asgjë të bëjmë, përveç t'i anulojmë projek-

DIGJET VETURA E OLIVER IVANOVIÇIT NË VERI TË MITROVICËS

Të premtën në orët e para të mëngjesit është djegur vetura e Oliver Ivanoviçit, liderit të Iniciativës Qytetare SDP (subjekt politik i komunitetit serb në Kosovë), në pjesën veriore të Mitrovicës. Zëvendësrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e Veriut, Besim Hoti ka konfirmuar për AA se policia sot rreth orës katër të mëngjesit ka marrë informacion se makina e parkuar është djegur në rrugën "Lola Ribar" në veri të Mitrovicës. "Ekipi i policisë ka shkuar menjëherë në vendin e ngjarjes për hetime por vetura ishte e djegur tërësisht. Rasti është klasifikuar si zjarrvënie dhe shkaktrim i rrezikut të përgjithshëm", theksoi Hoti. Ai tha se autorët dhe motivet e këtij incidenti nuk dihen por policia është në kërkim të autorëve mbi motivet e mundshme. Kjo është hera e dytë që shkatërrohet makina e Oliver Ivanoviçit. Sipas të dhënave zyrtare në vitin 2005 ishte vënë një bombë në veturën e tij, e cila ishte e parkuar para ndërtesës ku jetonte në veri të Mitrovicës. Ivanoviç është në pritje të rigjyqimit pas aktakuzës për krime të luftës. Ai pasi që qëndroi tre vite në burg, pret të gjykohet sërish.

et", ka thënë Apostolova, e cila ka shtuar se vendimin e kanë mbështetur edhe ambasadat e Gjermanisë dhe Francës në Prishtinë. Në anën tjetër, kryetari i Komunës së Mitrovicës veriore, Goran Rakiq, ditë më parë ka thënë se anulimi i projekteve është bërë për shkak se përfaqësuesja speciale e BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka kërkuar nga Komuna që të mundësohet vazhdimi i revitalizimit të urës kryesore mbi lumen Ibër, "pa ndonjë garanci për ruajtjen e sigurisë së qytetarëve". Rakiq, në prill të këtij viti, ka urdhëruar ndërprerjen e punimeve

për revitalizimin e urës, për shkak të një varg incidentesh, të cilat siç është thënë, e rrezikojnë sigurinë e qytetarëve. Por, Apostolova, gjithashtu ka thënë se ky vendim nuk ka asnjë ndërlidhje me revitalizimin e urës, ashtu siç ka deklaruar Rakiq. "Nuk ka asnjë lidhje ndërmjet këtyre dy projekteve me urën. Nuk ka kurrfarë ndikimi politik prapa këtij anulimi", theksoi Apostolova. Ndërkohë, zyrtarët e Policisë së Kosovës, patën theksuar se situata në Mitrovicë të veriut, në periudhën e fundit është e qëndrueshme dhe se nuk ka pasur incidente të mëdha.

Për tre vite në BE kanë hyrë 118.000 azilantë shqiptarë, janë deportuar 101 mijë

Statistikat zyrtare konstatojnë se qytetarët shqiptarë vazhdojnë të emigrojnë me shkallë të lartë drejt vendeve të BE-së. "Sipas Eurostat, gjatë tre viteve të fundit, përkatësisht gjatë periudhës 2014-2016, në ndonjë nga vendet e BE-së kanë hyrë mbi 118 mijë emigrantë ilegal nga Shqipëria. Numri më i madh i tyre apo 101 mijë janë deportuar, proces i cili vazhdon edhe në vitin 2017. Instituti evropian për statistika, Eurostat, në raport thekson se vetëm vitin e kaluar janë deportuar 42.600 qytetarë shqiptarë dhe se ata e kryesojnë listën e qytetarëve të deportuar nga vendet e BE-së me dallim të madh nga shtetet e tjera. "Gjatë vitit 2016, vendet e BE-së deportuan gjithsej 226 mijë emigrantë ilegal, që është numri më i madh pas atij në vitin 2008, prej kur Eurostat filloi ta kumtojë statistikën për hyrje dhe dalje të emigrantëve, me ç'rast çdo i pesti ka qenë shtetas shqiptar", lajmërojnë mediet shqiptare. Pas qytetarëve shqiptarë, në vend të dytë janë emigrantët nga Ukraina me 22.600 deportime, përderisa nga vendet ballkanike në vend të katërt është Kosova me mbi 13 mijë të deportuar.

Zjarr në një restaurant në Velipojë, disa të plagosur

Një restaurant në zonën e plazhit të Velipojës është përfshirë nga flakët paraditen e të premtës. Nga pamjet e dërguar në "Ti Raport" dallohen qartë tymi mbi çadrat e pushimit. Dyshohet se shkak i zjarrit ka qenë një bombolë gazi gatimi, por zjarrfikëset kanë mbërritur menjëherë në vendngjarje për shuarjen e flakëve. Pronari i lokalit, shtetasi Besnik Zenuni, 55 vjeç, ndodhet në gjendje të rëndë për shkak të plagëve të marra, ndërsa të lënduar kanë mbetur edhe 14 persona të tjerë. Vala e shpërthimit e flaku shumë metra tej pronarin e restaurantit në plazhin e Velipojës. Sipas policisë 55-vjeçari është në gjendje të rëndë. Po ashtu



edhe një kalimtar u godit shumë keq nga vala e shpërthimit. Dëshmitarët thonë se flaka doli nga kuzhina, ndërsa në lokal ndodheshin

pak persona. Tre klientë sapo largoheshin dhe fatmirësisht shpëtuan, ndërsa vala e flakës goditi një 19-vjeçarë që ndodhej pranë.

Dëshmitarët i thanë Top Channel se flaka u ngjit shumë lart duke përfshirë të gjitha ballkonet dhe dritaret e pallatit 5 katesh.

Katër të vdekur nga një aksident në Prishtinë

Policia e Kosovës ka konfirmuar se katër persona kanë humbur jetën si pasojë e një aksidenti që ka ndodhur tek rrethrotullimi kryesor në dalje të Prishtinës.

Të vdekur janë dy burra

e dy gra, përderisa një person tjetër (mashkull) ka marrë lëndime dhe po trajtohet në spital. "Mbrëmë, pas mesnate, rreth orës 00:57, është shkaktuar një aksident i rëndë trafiku në rrethrotullimin kryesor në

Prishtinë, rruga magjistrale Mitrovicë-Prishtinë. Automjeti ka rënë nga ura kryesore dhe si pasojë katër persona 2 meshkuj dhe 2 femra kanë vdekur, ndërsa edhe personi i pestë në gjendje të rëndë është dërguar në Qen-

dren Klinike Universitare për trajtim mjekësor", ka njoftuar Policia e Kosovës. Rasti është nën hetim. Ndërkohë që policia u bën thirrje qytetarëve që të kenë kujdes dhe të respektojnë rregullat në trafik.



Ligjvënësit amerikanë miratuan ligjin për sanksione të reja ndaj Rusisë, Iranit dhe Koresë së Veriut, i cili tash do t'i dërgohet për nënshkrim presidentit Donald Trump

Senati amerikan miraton sanksionet e reja ndaj Moskës



PUTIN: DO TË HAKMERREMI PËR SANKSIONET!

Rusia nuk do të rrijë duarkryq përballë sanksioneve të Shteteve të Bashkuara. Ky të paktën ishte premtimi i Presidentit rus, Vladimir Putin. Duke folur nga Finlanda, ku ndodhet për një vizitë zyrtare, shefi i Kremlinit iu përgjigj interesimit të mediave në lidhje me bllokun e ri të sanksioneve amerikane që kaluan në Dhomën e Përfaqësuesve. "Do të duhet të shohim tekstin final të këtyre sanksioneve dhe më pas të marrim një vendim. Por ne nuk mund të rrijmë duarkryq. Po na sos durimi dhe do të duhet të hakmerremi ndaj arrogancës amerikane", tha Putin. Për presidentin rus, sanksionet e reja amerikane janë "ekstremisht cinike". Paketa e re e sanksioneve e Uashingtonit synon të godasë Moskën për ndërhyrjen e saj në zgjedhjet presidenciale amerikane, e po ashtu edhe Korenë e Veriut dhe Iranin për programet e tyre të raketave ballistike dhe bërthamore. Por Moskë nuk është e vetmja kundër këtyre sanksioneve. Këtë herë Shtetet e Bashkuara nuk kanë në krah as Bashkimin Evropian, të paktën sipas asaj që sinjalizoi Jean Claude Juncker. "Amerika e para nuk do të thotë që interesat e Europës vijnë të fundit", deklaroi ai. Në fakt, sanksionet e reja parashikojnë ndëshkimin e të gjitha kompanitë që përfshihen në eksportin e gazit rus, çka do të rrezikonte ndërtimin e një gazsjellësi që lidh Rusinë me Gjermaninë. "Nëse shqetësimet tona nuk merren parasysh, jemi të gatshëm të veprojmë ashtu siç duhet brenda pak ditëve", vijoi Juncker. Drejtuesit e Dhomës së Përfaqësuesve dhe të Senatit në Kongresin amerikan arritën një marrëveshje në lidhje me paketën e sanksioneve. Në të parën paketa u kalua me një shumicë dërrmuese, ndërsa në Senat pritet që të votohet para nisjes së pushimeve të gushtit. Vetë Presidenti Trump nuk ka dhënë asnjë sinjal nëse do të vendosë veton, apo jo ndaj këtyre sanksioneve. Por edhe nëse vendoset vetoja, ajo rrezikon të shfuqizohet nga Senati nëse votohet në shumicë dërrmuese.

për një ligj me ndikim më të lehtë. Bashkimi Evropian po ashtu ka shprehur shqetësimin me sanksionet e reja, që sipas tij mund të ushtrojnë ndikim

në sektorin evropian të energjisë. Gjatë negociatave disa javëshe, administrata e Presidentit Trump fillimisht i kundërshtoi këto masa duke i quajtur ato

një përpjekje për të kufizuar aftësinë e ekzekutivit për të lehtësuar në mënyrë të njëanshme sanksionet, duke thënë se ato kufizojnë aftësitë e

SENATI I KA REFUZUAR MASAT PËR SHFUQIZIM TË REFORMËS SË OBAMËS

Senati i Shteteve të Bashkuara i ka hedhur poshtë masat për shfuqizim të reformës shëndetësore të ish-presidentit, Barack Obama, duke i dhënë goditje të fuqishme agjendës politike të presidentit, Donald Trump. Tre senatorë republikanë, përfshirë ligjvënësin John McCain, i cili aktualisht është diagnostikuar me kancer të rrezikshëm në tru, me votat e tyre vendimtare, janë shprehur kundër legjislatonit të propozuar. Rezultati përfundimtar i votimeve ishte 49 për dhe 51 kundër. "Ky ishte zhgënjim, me të vërtetë zhgënjim", u tha kolegëve pas votimit, lideri i shumicës republikane në Senat, Mitch McConnell.

Shteteve të Bashkuara në përpjekjet për të ndryshuar veprimet ruse dhe për të ndërtuar një marrëdhënie më të mirë me presidentin rus Vladimir Putin. Shqetësimi për këtë çështje u eliminua në fillim të javës, kur Shtëpia e Bardhë shprehu mbështetjen për projektligjin. "Presidenti mbështet

sanksionet ndaj këtyre vendeve dhe dëshiron të sigurohet që ato të mbeten në fuqi, por në të njëjtën kohë ai dëshiron të sigurohemi që të jemi në gjendje të arrijmë marrëveshje të mira për këto çështje. Këto dy gjëra janë shumë të rëndësishme për presidentin," u tha gazetarëve të hënën zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Sarah Huckabee Sanders. Zëvendësministri i Jashtëm rus Sergei Ryabkov tha të mërkurën se Moskë ka të ngjarë të hakmerret kundër Shteteve të Bashkuara nëse sanksionet hyjnë në fuqi. Sipas mediave shtetërore ruse, Ryabkov paralajmëroi se sanksionet e reja do të eliminojnë çdo shans për përmirësim të marrëdhënieve mes Moskës dhe Uashingtonit. Ai gjithashtu tha se Rusia e kishte paralajmëruar më parë administratën e Presidentit Trump se do të kundërpërgjigjej nëse ligjvënësit amerikanë miratojnë projektligjin për sanksionet. Në Capitol Hill, ligjvënësit tashmë kanë lavdëruar kalimin e ligjit. Kryetari i komisionit për punë të jashtme në Dhomën e Përfaqësuesve, Ed Royce, tha në një deklaratë se është i kënaqur që "senati votoi me shumicë për t'i dhënë administratës levatë aq të nevojshme ekonomike e politike për t'u përballur me kërcënimet nga Irani, Rusia dhe Koreja e Veriut. Ky ligj bipartizan ka të bëjë me mbajtjen e Amerikës të sigurt dhe i bëj thirrje presidentit ta nënshkruajë atë". Senatori Mark Warner, tha se ligji "i dërgon një mesazh të fuqishëm Vladimir Putinit se sulmet mbi demokracinë tonë nuk do të tolerohen. Presidenti Trump duhet ta nënshkruajë atë sapo t'i arrijë në tryeze. Në të kundërtën, ai rrezikon të trimërojë ndërhyrjet ruse në zgjedhjet e ardhshme". (VOA)

Automjetet me benzinë dhe naftë drejt fundit të tyre



Prej vitit 2040 në Britaninë e Madhe dhe në Francë do të lejohen të qarkullojnë vetëm makina elektrike. Gjermania pritet të pasojë. "Brenda një afati të shkurtër duhet të marrë fund teknologjia e motorëve me djegie të brendshme", tha eksperti për transportin i CDU-

së Oliver Wittke për Deutschlandfunk. Wittke ju referua planeve të Britanisë së Madhe që duke filluar nga viti 2040 të ndalojë shitjen e automjeteve me naftë dhe benzinë. Shkatërrimi i mjedisit është shumë i lartë, tha për BBC-në ministri i Mjedisit Michael Gove. Partia konservative ka premtuar se deri në vitin 2050 nuk do të ketë më automjete me naftë ose benzinë në rrugët tona", tha Gove. Kjo do të thotë që nga viti 2040 nuk do të lejohet regjistrimi i makinave të reja me benzinë dhe naftë, por në rrugët e Britanisë do të ketë vetëm automjete elektrike. Franca gjithashtu planifikon një ndalesë të tillë nga viti 2040. Tani edhe Gjermania në konsultim me partnerët evropianë duhet të caktojë një datë për ndalimin e automjeteve me motorë me djegie të brendshme. Ministri i landit Baden-Württemberg Winfried Kretschmann ka kritikuar në lidhje me këtë, ministrin e Transportit Alexander Dobrindt, që sipas tij nuk ka marrë masa të mjaftueshme që në fillim për këtë krizë. "Ministri Dobrindt gjatë gjithë kohës nuk na ka mbështetur aspak" tha Kretschmann për ARD-në. Poltikanët Gjermanë kërkojnë një takim mes qeverisë dhe kompanive automobilistike në fillim të gushtit, për të folur për ndryshimet dhe heqjen dorë nga motorët me naftë dhe benzinë. Kretschmann

është më i kujdeshëm në parashikime dhe kërkon që makinat me naftë të përmirësohen që në mënyrë efektive të ulen niveli i dëmimit të mjedisit nga grimcat. Nëse nuk arrihet kjo, ai mendon se këto automjete duhet të nxirren nga qarkullimi. Organizata për mbrojtjen e mjedisit Greenpeace thotë se kjo nuk mjafton. Eksperti për transportin i Greenpeace, Tobias Astrup, i bën thirrje qeverisë gjermane që të marrë masa të nevojshme duke thënë: "Vetëm nëse këto qëllime arrihen deri në vitin 2025, industria themelore e Gjermanisë do të jetë në gjendje të sigurojë mbijetesën e saj dhe atë të planetit."

Gjykata shkarkon kryeministrin

Gjykata supreme e Pakistanit shkarkoi nga detyra kryeministrin Nawaz Sharif në një vendim unanimit për akuza për korrupsion, zhvillim që padyshim do të trazojë edhe më shumë skenën e cekuilbruar politike në vend. Vendimi i dhënë nga

5 gjykatës, i jep fund një viti kontradikte politike që nisi me publikimin e të ashtuquajturave Panama Papers, në të cilat shkruhej se fëmijët e kryeministrit ishin përfshirë në blerje pronash të shtrenjta në Londër përmes kompanive anonime. Tashmë që

Shafir u shkarkua, pritet që partia qeverisëse Liga Myslimane pakistaneze të zgjedhë një kryeministër të përkohshëm që të drejtojë vendin deri në zgjedhjet e përgjithshme të 2018-s. Vendimi i gjykatës kushtetuese është një fitore e madhe për liderin e

opozitës Imran Khan, i cili kërkonte shkarkimin e kryeministri Sharfi që kur skandali shpërtheu. Telasht e Sharif nuk mbarojnë më vendimin e gjykatës supreme, por sapo kanë nisur, pasi gjykatësit të gjithë materialet e mbledhura gjatë hetimit ja

kaluan zyrës kombëtare për llogaridhënie dhe rekomanduan hapjen e çështjeve ndaj ish kryeministrit dhe tre fëmijëve të tij. media lokale në Pakistan shkruajnë se hetimi kriminal ndaj Sharif dhe familjes së tij pritet të nisë së shpejti.

Treni përplaset në stacion, 48 të plagosur në Barcelonë

Të paktën 48 persona janë plagosur, pesë prej tyre në gjendje të rëndë, pasi treni u përplas në një stacion të qytetit spanjoll të Barcelonës, bëjnë të ditur zyrtarët. Incidenti ndodhi gjatë orëve të mëngjesit në stacionin Francia, në qendër të qytetit. Raportimet thonë se treni nuk frenoi dot kur hyri në stacion, duke goditur platformën. Pamjet në rrjetet sociale tregojnë pjesë e parme të dëmtuar të mjetit. 18 persona janë dërguar në spital, kanë bërë të ditur në Twitter zyrtarët e emergjencave të Barcelonës.



Pak para eventit më të madh kulturor në Kosovë, drejtori artistik i Dokufest, Veton Nurkollari, tha për BIRN se festivali i filmit në Prizren po përmirëson kinematografinë në Kosovë.

Dokufest



Skënderbeut edhe në Budapest

Në Budapest, do të vendoset statuja e heroit kombëtar të Shqipërisë, Skënderbeu. Ambasadori i Shqipërisë në Hungari, Arian Spasse ka zbuluar detaje nga ndërtimi i këtij busti, i cili siç shihet në foto është ende i papërfunduar. Spasse ka zhvilluar një vizitë studion e skulptorit Mihaly Gabor, i cili po realizon projektin.

Busti do të vendoset përballë bashkëkohësit të Skënderbeut, heroit hungarez, Janos Huniadi.

“Edhe në Budapest do të vendoset statuja e Skënderbeut. Sot Ambasadori Spasse vizitoi studion e skulptorit Mihaly Gabor, për të parë maketin me përmasa reale. Pas disa ndryshimeve në fizionominë e portretit dhe lejes përfundimtare të Këshillit Bashkiak, statuja do të vendoset në parkun qendror të qytetit, përballë statujës së Janos Huniadi”, shkruhet në faqen zyrtare të Ambasadës Shqiptare në Hungari.



Transformimi i kinematografisë në Kosovë

“Tema e këtij viti është e ardhmja dhe jemi optimistë se e ardhmja është e bukur. Kështu që synojmë ta përcjellim këtë nëpërmjet programit tonë të filmave, programit muzikor, bisedimeve dhe fushatave,” tha për BIRN drejtori i Dokufest, Veton Nurkollari

Die MORINA

Festivali i 16-të Ndërkombëtar i Filmit Dokumentar dhe atij me Metrazh të Shkurtër në Prizren, Dokufest, do të shfaqë një total prej 253 filmash në qytetin jugor të Kosovës nga data 4 deri më 12 gusht nën sloganet “E ardhmja është dashuria ime” dhe “E ardhmja s’ka vdekur”.

Rreth 102 nga këta filma do të jenë në gjashtë kategori konkurruese, duke përfqësuar 50 vende, përfshirë dy premiera botërore, dy premiera ndërkombëtare dhe një sërë premierash europiane dhe rajonale. Tetë filma nga konkursi kombëtar i Kosovës gjithashtu do të kenë gjithashtu premierat

e tyre botërore në festival.

“Tema e këtij viti është e ardhmja dhe jemi optimistë se e ardhmja është e bukur. Kështu që synojmë ta përcjellim këtë nëpërmjet programit tonë të filmave, programit muzikor, bisedimeve dhe fushatave,” tha për BIRN drejtori i Dokufest, Veton Nurkollari.

Ai theksoi se eventit më i rëndësishëm kulturor në Kosovë është rritur çdo vit dhe ndërsa kjo ndodh, gjithnjë e më shumë regjisorë të rëndësishëm po aplikojnë të shfaqin filmat e tyre këtu, disa si premiera botërore. Sipas Nurkollari, shumë nga filmat që do shfaqen në Prizren janë të rinj dhe vijnë direkt nga festivale të mëdhenj ndërkombëtarë.

“Ne kemi filmin që fitoi çmimin e kritikës në festivalin e Kanës dhe fituesit e festivaleve të filmit Berlinale, Sundance dhe Tribeca dhe shumë festivale të tjera të rëndësishme. Një pjesë e madhe e filmave më të mirë të vitit do të jenë në Dokufest.”

Ai shtoi se tashmë është bërë traditë që të paktën katër ose pesë filma të shfaqur në

Dokufest më vonë hyjnë në konkurse për çmime ndërkombëtare, siç janë edhe çmimet Oskar.

Sipas Nurkollari, ata që përfitojnë më shumë nga programi i festivalit janë vetë qytetarët e Kosovës dhe sidomos prodhuesit e filmave.

“Do të presim një retrospektivë të dy prodhuesve filmash, regjisorit britanik John Smith dhe regjisorit amerikan Travis Wilkerson, të cilët do të japin leksione dhe kjo është një mundësi e jashtëzakonshme sidomos që prodhuesit e rinj të filmave të mësojnë nga mjeshtrit e kinemasë,” tha Nurkollari. Nëpërmjet leksioneve të tilla dhe programeve në të tjera në festivalet e filmit në Kosovë, sipas Nurkollari, cilësia e filmave në Kosovë është përmirësuar ndjeshëm. “Cilësia e filmave tanë është e pakrahasueshme me atë që ishte 16 vjet më parë. Numri i filmave që prodhohen tani është gjithashtu i pakrahasueshëm me numrin e filmave që prodhoheshin atëherë, kështu që ka arsye të mirë për të qenë të kënaqur,” shtoi Nurkollari. Ndërkohë që tema kryeso-

re e filmave të pasluftës në Kosovë ka qenë lufta për pavarësi, pasojat e luftës apo tema sociale, Nurkollari tashmë vë re një zhvendosje drejt “një porte të vogël drejt filmit eksperimental”.

“Është shumë interesante dhe inkurajuese për mua që prodhuesit e filmave në Kosovë po përpiqen të eksperimentojnë me të dyja, formën dhe zhanrin. Shoh kapacitetin e prodhuesve të rinj të filmave që me sy të hapur janë në gjendje të ndjekin trendet dhe t’i shndërrojnë ato në filma,” tha ai. Nurkollari thotë se kinematografia në Kosovë po përmirësohet çdo vit dhe festivale janë një nga faktorët që kanë ndihmuar. “Ne e nisëm kinematografinë nga hiçi, pasi Kosova nuk ka shkollë filmi. Nuk mund të pretendojmë të shkojmë në finalen e Ligës së Kampionëve kur nuk kemi terren për futboll. E njëjta gjë është edhe me filmin,” tha ai.

Megjithatë, “të mos harrojmë që filmat e Kosovës kanë qenë kandidatë për çmime Oskar, kanë fituar në BAFTA dhe në Sundance,” shtoi ai.

Çfarë shpëtoi pas bombardimit të Mosulit?

Në mes të gërmadhave që luftimet e gjata kanë shkaktuar, një godinë gjendet aty, në mes të qytetit, thujse e paprekur. Ushtarët e shohin me kureshtje, banorët me frikë, ndërsa të huajt me admirim

Andreas DUSHI

Qyteti i Mosulit është kthyer në një vatër luftimesh të përgjakshme mes ushtrisë qeveritare dhe terroristëve të ISIS. Ndonëse forcat qeveritare arritën të merrnin Mosulin pas ditëve të tëra përleshjeje, qyteti vazhdon të jetë



mbuluar nga një pluhur i dendur i shkaktuar nga luftimet. Për ato që nuk e braktisën Mosulin, “dita e

çlirimit” ka qenë dita më e bukur, ndoshta në tërë jetën e tyre. Ndërsa, ato që e braktisën, tani duhet

të mendojnë të kthehen aty pasi gjithçka po shkon drejt normalitetit.

ISIS po humbet terri-

tor ndërkohë që, sipas burimeve të mediave pranë organizatës terroriste, edhe kreu i saj ka vdekur. Nëse skenari do të jetë i ngjashëm me atë të organizatës tjetër terroriste Al-Qaeda, ISIS duhet të reshtë së vepruari, pasi Al-Qaeda nuk u dëgjua më, qysh pas vdekjes së Osama Bin Laden, liderit të saj. Në mes të gërmadhave që luftimet e gjata kanë shkaktuar, një godinë gjendet aty, në mes të qytetit, thujse e paprekur. Ushtarët e shohin me kureshtje, banorët me frikë, ndërsa të huajt me admirim. Kjo godinë është biblioteka legjendare, shumë e njohur për pasurinë e rrallë të dokumenteve me rëndësi të madhe, kryesisht his-

torike, Biblioteka e Mosulit.

Siç duket, përveç fanatikëve që e deshën qytetin aq sa ishin të gatshëm të luftonin për të, librat nuk pranuan të largoheshin nga Mosul, por qëndruan aty, ndoshta duke u lutur në heshtje, që të mos pësonin fatin e Bibliotekës së Aleksandrisë. Lutjet e tyre u dëgjuan dhe Biblioteka e Mosulit sot qëndron në këmbë mes gërmadhash duke u ngjitur deri lart në majën e historisë.

Biblioteka e Mosulit ngjan me Kullën e Babilonisë me një ndryshim të vetëm: Kulla e Babilonisë nuk arriti ta çonte zërin e saj deri lart te Krijuesi, ndërsa Biblioteka e Mosulit po!



"Ndoshta momenti vendimtarë i lojës ishte golin që e morëm në fillim të ndeshjes, filluam në pjesën e dytë me një rast ku prapë nuk e shfrytëzuam, që më pas të ndodhin ato dy kartonët, ku është vështirë të luash me dy futbollistë më pak. Megjithatë kur ti analizojmë ndodhitë në fushë mendoj se është një rezultat i hapur dhe rezultat që na jep shpresë për kualifikim", thotë trajneri i Shkëndijës Qatip Osmani

Ismaili ia sjell fitoren e parë Shkupit në ndeshjet miqësore



Shkup, 28 korrik - Ekipi i Shkupit të enjten pasdite ka luajtur dhe ndeshjen e dytë kontrolluese në kuadër të përgatitjeve në Mavrovë. Kësaj radhe për kundërshtarë kishte ekipin e respektuar të Gostivarit që është përforcuar me një numër të konsiderueshëm të futbollistëve nga Liga e Parë dhe që është me ambicie që sezonin e ardhshëm të jetë në mesin e ekipeve më të mira në Maqedoni. Ndeshja e filloi dhe mbaroi me dominim të plotë të Shkupit, por që në këtë takim arriti që vetëm një herë të tundë rrjetin e mysafirëve. Edhe në jetë ndeshje sulmuesit e Shkupit treguan se po zhvillojnë përgatitje cilësore dhe nga dita në ditë po arrijnë formë të mirë. Fillimisht Emmanuel Mbella kishte një rast të bukur, që më pas të edhe Fatih Ismaili të provojë shkathtësitë e portierit të Gostivarit. Një predhë të vërtet në minutën e 18-të e kishte Ermedin Adem, por që topi kaloi vetëm pak centimetra skaj portës. Më pas 10 minuta

më vonë portieri i Gostivarit sprovohet edhe nga Muharrem Bajrami, goditjen e të cilit me forcë të fundit arrin ta dëbojë në rivënie këndi. Me rezultatin e barabartë pa gola përfundoi në rrjetë. Gjithashtu edhe Suhejl Muharremi kishte një tentim me kokë, por që topi shkoi mbi transversale, ndërsa më pas Omar Imeri pas një driblimi të bukur doli para portierit por në fund nuk arriti të shënojë. Dhe kur të gjitha këto raste nuk u realizuan, golin e vetëm të ndeshjes e shënoi Fatih Ismaili në minutën e 50-të. Më pas pasuan edhe disa tentime të sulmuesve të Shkupit, si Husein Demiri dhe Alen Jashrarovski të cilët goditën me kokë, por duke mos e gjetur cakun e dëshiruar. Ndeshjen e radhës Shkupi e luan me 30 korrik në Mavrovë, kur përballë do të ketë ekipin e Flamurtarit të Prishtinës.

Shkëndija humbin, por rruan shpresat për kualifikim

Shkup, 28 korrik - Skuadra e Shkëndijës ka pësuar disfatë minimale, e para në garat e deritanishme në kuadër të turit të tretë kualifikues për Liga Evropë. Me rezultatin 2:1 kuqezinjtë u mundën nga skuadra e Trakait, rezultat ky që u jep shpresë që në ndeshjen kthyese të enjten e ardhshme të sigurojë kualifikimin në plej-of, sukses të cilin e arriti vitin e kaluar, por që u mund nga belgët e Genkut. Autor i golit që u jep shpresë kuqezinjtë për kualifikim në plej-of ka qenë braziliani Zhunior, derisa vlen të përmendet edhe ajo se Shkëndija ndeshjen e përfundoi me dy lojtar më pak. Zhunior u ndëshkua direkt me karton të kuq, ndërsa Cuculi u ndëshkua me të kuq pas dy kartonëve të verdhë,

EJUPI DEL SI FITUES NGA FUSHA E AINDHOVENIT

Osijeku, ku aktivizohet dy futbollistët shqiptar Muzafer Ejupi dhe Eros Grezda, kanë dhuruar një nga surprizat më të mëdha të ndeshjeve të para të turit të tretë paraeliminator të Ligës së Evropës, duke mundur si mysafir me rezultatin 1-0 ekipin e PSV Aindhoven. Sulmuesi shkupjan dhe mesfushori kosovar luajtën 90-minutat e kësaj sfide përballë skuadrës së njohur holandeze, në duelin që u mbyll me fitoren 1-0 të ekipit kroat. Goli i vetëm i ndeshjes u shënuar me penallti nga Barisiç.

kështu që të dyt do të mungojnë në ndeshjen kthyese. Ndryshe, trajneri i skuadrës tetovare, Qatip Osmani pas përfundimit të ndeshjes vlerësoi se Shkëndija kontrolloi ndeshjen, por pas dy kartonëve të kuq ky rezultat është i pranueshëm duke llogaritur golin e shënuar në transfertë, që sipas tij ka peshë të madhe. "Sigurisht se pjesën e parë,

pjesën më të madhe të ndeshjes e dominuam, ku krijuam edhe disa raste, e barazuam 1:1 dhe kishim disa raste të qind për qindta të cilat nuk i realizuam. Ndoshta momenti vendimtarë i lojës ishte golin që e morëm në fillim të ndeshjes, filluam në pjesën e dytë me një rast ku prapë nuk e shfrytëzuam, që më pas të ndodhin ato dy kartonët,

ku është vështirë të luash me dy futbollistë më pak. Megjithatë kur ti analizojmë ndodhitë në fushë mendoj se është një rezultat i hapur dhe rezultat që na jep shpresë për kualifikim", deklaroi Qatip Osmani. Në ndërkohë, me rezultatin identik (2:1) është mundur edhe Skënderbeu nga Korça. Korçarët u mposhtën të enjten në mbrëmje nga skuadra e Mlada Boleslav, por goli i shënuar si mysafir u jep shpresë atyre për një kualifikim në turin tjetër respektivisht në plej-of. Ndeshja kthyese ndërmyet këtyre dy skuadrave zhvillohet më 3 gusht në Shkodër. Skënderbeu synon ta përsërisë suksesin e para dy edicioneve, kur arriti të kualifikohet në fazën e grupeve të Ligës së Evropës.

Napoli këmbëngul për Rashicën



Klubi i presidentit Aurelio de Laurentis vazhdon të monitorojë talentin e Përfaqësueses së Kosovës, Milot Rashica, i nxitur edhe nga agjentët e merkatos së të kaltërve që besojnë se Rashica ka potenciale të mëdha. Napoli e ka ndjekur 21-vjeçarin edhe gjatë verës së shkuar por nuk arriti ta finalizonte marrëveshjen me Vitessen, në këtë mënyrë, klubi italian është hedhur sërish në sulm për të evituar konkurrencën e

klubeve të tjera. Në fakt, Serie A mund të jetë destinacioni më i mundshëm për talentin e Vitesses pasi në gjurmët e tij janë vënë edhe Milan e Udinese. Sipas "Mediaset", kuqezinjtë kanë shfaqur interes, ndërsa klubi i presidentit Pozo mund të jetë një tjetër destinacion ku Rashica mund të shpërthejë përfundimisht për të hedhur hapin e madh të karrierës. Gjithsesi, për momentin situata mbetet e pandryshuar pasi Vitese kërkon të arketojë sa më shumë nga sulmuesi i krahut që ka shpërthyer në radhët e ekipit holandez. Kartoni i futbollistit të lindur në Vushtri vlerësohet rreth 8 milionë euro në treg nga Vitese, aty ku gjatë dy sezoneve të fundit Rashica ka qenë një prej titullarëve të padiskutueshëm, duke luajtur mbi 60 ndeshje në Eredivisien holandeze, duke realizuar edhe 10 gola.

Kaçe në "radarin" e Panioniosit

Ergys Kaçe në radarin e Panionios. Ky është titulli i portalit grek "Newsnowgr.com" që zbulon prapaskenën e merkatos për mesfushorin shqiptar të PAOK-ut. Lojtari i lindur në Korçë nuk u përfshi në listën e lojtarëve që u aktivizuan në ndeshjen e "Europa League" kundër Olimpik Donetsk, pasi trajneri Aleksandar Stanojeviç ka lënë të kuptohet se 24-vjeçari nuk është në planet e tij për këtë se-

zon. Kjo ka bërë që klubet greke të tentojnë afrimin e shqiptarit dhe një prej tyre është klubi nga Athina. "Mesfushori është në majën e listës së dëshirave të klubit nga lagjja "New Smyrna", por për të finalizuar marrëveshjen e huazimit klubet duhet të bien dakord. Një prej pikave që po ndan palët është çështja e pagës sepse Panionios kërkon që një pjesë të saj ta marrë për sipër klubi nga Selaniku. Sezonin e

shkuar, Panionios bëri një paraqitje mjaft të mirë në kampionat duke u renditur në vendin e pestë por pas fazës plej off, ekipi nga periferia e Athinës nuk arriti të ngjitej mes tre të parëve për të siguruar një biletë evropiane. Gjithsesi, Panionios ka nisur një projekt ambicioz për ndërtimin e një skuadre të fortë për sezonin e ardhshëm dhe objektivi kryesor është futja në zonën evropiane.



Sadiku i lumtur për golin, por jo edhe për rezultatin

Një debutim me gol në Ligën e Kampioneve është gjithmonë ndjesi e bukur. Por Armando Sadiku nuk ka mundur t'i gëzohet siç duhet kësaj arritje të vogël personale, pasi klubi i tij, Legia e Varshavës, është mundur me shifrat 3-1 në Kazakistan përballë Astanës vendase. "Jemi të inatosur", ka pranuar sulmuesi shqiptar pas ndeshjes. "Nuk duhej të pësonim golin e tretë.



Nëse do të mbyllej ndeshja me humbje 2-1, do të kishim qenë më të qetë. Në pjesën e dytë kishim mundësi të shënonim një tjetër gol, ndaj jemi vetë fajtorë të kësaj situatë. Por nuk ka mbaruar asgjë. Mund të fitojmë 2-0 në ndeshjen e kthimit, por do të duhet të bëjmë më shumë. Nuk duhet të përsëritim gabimet e kësaj ndeshje", deklaroi Sadiku për mediat polake.



Ky 'restart' shpresoj të jetë më i mirë se sa ai në prill, pasi duaj të luaj më shumë dhe të tregoj se jam sërish një kampione

"Mbreti" u largua dhe tifozët bavarezë të pranishëm në stadium duartrokritën për ta mbështetur, ngaqë kjo ishte ndeshja e fundit e rekordmenëve në Azi për këtë tur veror. Derisa trajneri Karlo Ançelotti, megjithatë, i qetësoi të gjithë pas takimit duke thënë se 'Frank ka pësuar një të çarë të vogël'

Mesfushori i Bajernit, Frank Riberi, do të duhet të qëndrojë për tri-katër ditë jashtë fushave pas dëmtimit që pësoi të enjten në kaviļje në miqësoren me Interin (0-2) në Singapor. Francezi po luante shumë mirë ndaj skuadrës zikaltër. Ai "ngacmoi" i pari portierin Samir Handanoviç pas gjashtë minutash lojë dhe bëri gjithçka që Bajern të shënonte, por në të 33' u detyrua të linte ndeshjen, madje pa mundur ta prekte tokën me këmbën e dëmtuar. Teksa dy skuadrat pushuan për të pirë ujë, "Mbreti" u largua dhe tifozët bavarezë të pranishëm në stadium duartrokritën për ta mbështetur, ngaqë kjo ishte ndeshja e fundit e rekordmenëve në Azi për këtë tur veror. Derisa trajneri Karlo Ançelotti, megjithatë, i qetësoi të gjithë pas takimit. "Frank ka pësuar një të çarë të vogël, vetëm kaq", - u shpreh italian. Ndërkohë, pavarësisht rezultatit, ai shtoi se miqësorja shkoi mjaft mirë, duke marrë

Dëmtimi në kaviļje, Ançeloti qetëson tifozët



Riberi do të mungojë vetëm 3-4 ditë



parasysh faktin se u provuan shumë të rinj. Bajern do të luajë ndeshjen e parë zyrtare më 5 gusht në Superkupën e Gjermanisë. Rivali i bavarezëve do të jetë Borussia Dortmund. 13 ditë më vonë, kampionët e Bundesligës do të nisin kampionatin përballë Bayer Leverkusentit.



Fettel pret fitore në garën e 50-të me Ferrarin

Sebastian Fettel rrezikon kreun e renditjes në Formula 1, pasi avantazhi që ka me Luis Hamilton është vetëm 1 pikë avantazh. Dy garat e fundit nuk kanë qenë shumë fatlume për "kokëkuqen", që kërkon në Hungari të rikthehet te suksesi në kampionat. "Mercedes është paraqitur më mirë, por ne nuk kemi pasur shumë fat. Ndonjëherë ndodh që gjërat të shkojnë keq edhe pse e dimë që mund të duelojmë për fitore", u shpreh piloti gjerman i Ferrarit, që do të zhvillojë garën e 50-të në karrierë me makinën italiane. "Gara e 50-të me Ferrarin? Mund të them që ky vit ka qenë shumë më i mirë. Ne duam që Ferrari të jetë kompetitiv dhe këtë sezon kemi përmirësuar ndjeshëm. Ne duam të fitojmë çdo garë, duke nisur nga sfida e radhës në Hungari, duke mos u dhënë asnjë mundësi rikuperimi të tjerëve", deklaroi Fettel për mediat nga pista e Hungaroringut. Në renditjen e përgjithshme, piloti gjerman ka 177 pikë, 1 më shumë se Hamilton me Mercedes, ndërkohë që kjo është gara e fundit para pushimeve verore.

Sharapova: Dua të tregoj se jam sërish kampione

Maria Sharapova përgatitet për rikthimin në fushë pas një dëmtimi të pësuar që në turneun "Masters" të Romës. Ajo ka qëndruar për gati 3 muaj pushim, por tani është gati për të rinisur aventurën e saj, këtë herë në fushat me çimento të Amerikës. "Më ka munguar shumë fusha. Fakti që u dëmtova pas rikthimit më ka mërziur, pasi synoja të luaja më shumë. Jam përgatitur mirë, jam gati për një sipërfaqe të vështirë dhe dua të bëj një paraqitje të mirë", u shpreh tenistja ruse, optimiste për të ardhmen e saj. "Jam përgatitur mirë, jam gati për një sipërfaqe të vështirë dhe dua të bëj një paraqitje të mirë", shtoi më tej ajo. Ndryshe, Sharapova ka marrë një ftesë nga organi-



zatorët e turneut "Masters" të Sinsinatit, që nis më 14 gusht dhe i paraprin grand slemnit të "US Open". "Dua t'i ngjis shkallët një e nga një dhe të jem në maksimum në 'US Open'. Falënderoj organizatorët e turneut të Sinsinatit për ftesën, shpresoj që të bëj një paraqitje të mirë. Ky 'restart' shpresoj të jetë më i mirë se sa ai në prill, pasi duaj të luaj më shumë dhe të tregoj se jam sërish një kampione", deklaroi sot për mediat tenistja ruse Maria Sharapova.

Kornier kërkon hakmarrje ndaj Xhones

UFC 213 do të zhvillohet mëngjesin e së dielës, 30 korrik, në "Honda Center të Anaheim", Kalifornisë. Evenimenti kryesor do të jetë revanshi i kampionit të peshës së "light heavyweight" mes Daniel Kornier dhe ish-kampionit Xhon Xhones. Ata do të ndeshen për të dytën herë në karrierën e tyre me Xhones që fitoi sfidën e parë pas vendimit unanimit të gjyqtarëve pas pesë raundesh brutale. Ndryshe, në prag të kompeticionit, yjet e UFC



214 u mbloodhën për një konferencë për shtyp ku folën për mediat, derisa si gjithmonë, atmosfera ishte e nxehtë. Një gazetari i MMA nuk i shpëtoi luftës së fjalëve pas një pyetjeje që i bëri Xhon Xhones, me luftëtarin që e turpëron duke thënë se

nuk e pëlqen si gazetari kështu që nuk do t'i përgjigjet pyetjes. Pati përplasje midis dy armiqve të urreyer të UFC, me Kornier që e akuzonte për abuzimin me drogën, ndërsa Xhones për substancat e palejuara që ka marrë në të shkuarën. Ndërkohë, UFC 214 ka një gjë të garantuar: spektaklin. Përveç eventit kryesor do të ketë edhe dy sfida të tjera për titullin kampion. Një formacion yjesh këtë fundjavë.

Publicitet

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Maqedonisë

SH P A L L

Kërkesë për dhënie e Lejes për kaptazhin dhe përdorimin e ujit nga lumi Shtallkovska për prodhimin e energjisë elektrike për HCV lumi Shtallkovska me nr. ref. 364.

Në përputhje me nenin 30 paragrafin 1 të Ligjit të Ujërave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 87/08, 09/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 163/13, 180/14, 146/15 dhe 52/16), në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dorëzoi Kërkesë për kaptazhin dhe përdorimin e ujit nga lumi Shtallkovska për prodhimin e energjisë elektrike për HCV lumi Shtallkovska me nr. ref. 364, komuna e Probishtipit.

Parashtruesi i kërkesës:

"DIS ENERGIJA" SHPK Shkup
Rr. "Veselin Maslesha" nr.9/2-11
1000 Shkup

Lokacioni i kaptazhit të lumit Shtallkovska është në afërsi të f. Shtallkovci në PK 594 KK Shtallkovica (640 l.m.b) me koordinatat vijuese:

Y=7 606 784,2981 ; X=4 650 900,1988;

Lokacioni i parashkuar për ndërtimin e centralit elektrik të HCV të lumit Shtallkovska me nr. Ref. 364 të PK 129, KK Minierat Turke është me koordinatat vijuese:

Y=7 605 053,9976; X=4 649 328,6165

Informacione në lidhje me kërkesën, publiku i interesuar mund të marrë në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në e-mail b.apostolova@moepp.gov.mk
Publiku i interesuar, në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të kërkesës, ka të drejtë të paraqesë mendime dhe komente me shkrim në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në bulevardin "Goce Dellçev" nr. 18 të ndërtesa e RTM (kat i 10), 1000 Shkup.

Djali i Klaivert nënshkruan kontratë historike me "Nike"

Pesë vite kontratë me "Nike", kompania e njohur e veshjeve sportive që shpesh sponsorizon futbollistë dhe skuadra të ndryshme. Çfarë ka për t'u çuditur? Personi që ka nënshkruar është vetëm 9 vjeç. Messi i ri i futbollit? Pasardhësi i Maradonas? Ndoshta do të ndodhë në të ardhmen. Për momentin, Shane Klaivert, djali i Patrik, ish-sulmuesi i Holandës, Ajaksit, Barcelonas dhe Milanit, e konsideron gjithçka si një lojë. Pak a shumë, si të veshë fanellën dhe këpucët e babait, duke ëndërruar që të bëhet kampion një ditë. Dhe këtu qëndron thelbi i çështjes: para një marrëveshje ekonomike, detajet e së cilës nuk janë bërë publike, a mund të flitet akoma për një "ëndërr"? Ndërkohë, Xhastin, djali i madh i Patrik Klaivert, ka debutuar janarin e kaluar me fanellën e Ajaks. Vëllai i vogël Shane, pas marrëveshjes me kompaninë amerikane, është bërë sportisti më i ri në Evropë që ka nënshkruar një kontratë me sponsorin amerikan.





Nëse them se ai nuk është për t'u shitur, nuk është për t'u shitur. Nuk kam asgjë tjetër për të thënë. Është një vendim i klubit, është vendimi im. Kështu është

“Reds” “shtrengon” Kutinjon pas presioneve nga Barcelona

LIVERPULI TANI KËRKON 135 MLN EURO

Barcelona nuk ka dorëzuar një ofertë të përmirësuar për lojtarin më të paguar të Liverpulit dhe raportet nga Spanja sugjerojnë se “Merseysiders” kanë caktuar një tarifë për të, me shuma kontradiktore, që shkojnë nga 89 deri në 134 milionë euro janë të pasakta, pasi nuk ka pasur negociata



Liverpul insiston që Philippe Kutinjo nuk është në shitje, pasi Barcelona po përpiqet të intensifikojë ndjekjen e saj për ndërkombëtarin e Brazilit. “Reds” hodhën poshtë një ofertë prej 72 milionë eurosh nga gjigandët spanjollë një javë më parë, me mesazhin se nuk do të sanksiononin shitjen e 25-vjeçarit me asnjë çmim. Kutinjo dha një “masterclass” në fitoren 2-1

kundër Leicester Siti, në finalen e “Premier League Asia Trophy” në Hong Kong, të shtunën, dhe ka marrë pjesë në çdo seancë trajnimi që kur klubi vazhdoi përgatitjet parasezonale në “Rottach-Egern”, Gjermani. Ndërkohë, Barcelona nuk ka dorëzuar një ofertë të përmirësuar për lojtarin më të paguar të Liverpulit dhe raportet nga Spanja sugjerojnë se “Merseysiders”

kanë caktuar një tarifë për të, me shuma kontradiktore, që shkojnë nga 89 deri në 134 milionë euro janë të pasakta, pasi nuk ka pasur negociata. Jürgen Klopp ka deklaruar vazhdimisht se maestro i lindur në Rio nuk do të largohet nga “Anfield” këtë verë, një qëndrim i apikuar për të gjithë lojtarët kryesorë të skuadrës. “Nëse them se ai nuk është për t'u shitur, nuk

është për t'u shitur, – deklaroi gjermani gjatë fundjavës. – Nuk kam asgjë tjetër për të thënë. Është një vendim i klubit, është vendimi im. Kështu është”, deklaroi trajneri gjerman. Bosi i “Reds” zhvilloi bisedime me Kutinjon, i cili nënshkroi një marrëveshje të re pesëvjeçare në janar, pa një klauzolë lirimi, pas refuzimit të propozimit të Barcelonës nga Liverpuli.

UEFA përgënjeshtrohet Barçën, “shtyn” Nejmar drejt PSZH

PSZH dëshiron të blejë Nejmarin dhe i ka fondet për të paguar klauzolën për prishjen e kontratës së brazilianit me Barcelonën. Në ditët e kaluara, disa drejtues të katalanasve kanë siguruar tifozët se asnjë klub nuk mund ta paguajë klauzolën, për shkak se do të thyente rregullat e “Fair Play”-it të UEFA-s. Javën e kaluar, presidenti i Barcelonës Bartomeu ka thënë se: “Nuk është e mundur të paguhen klauzola të tilla, nëse nuk do të shkelësh rregullat e ‘Fair Play’”. Por nëse dikush nuk do t'i respektojë rregullat, klauzola mund të paguhet”. Një deklaratë kjo që është përgënjeshtrohet nga Andrea Traverso, kryetari i komisionit të “Fair Play”-it të UEFA-s, i cili, në një intervistë të dhënë për “Gazzetta dello Sport”, ka thënë se PSG ka ndjekur rregullat e vendosura nga

organizmi më i rëndësishëm i futbollit evropian. “Ne jemi të kënaqur me FFP (Financia Fair Play). Kemi arritur rezultate të jashtëzakonshme në vitet e fundit. Në 2010-ën futbolla ka humbur 1,7 miliard euro, ndërsa tani këto humbje janë 300 milionë”. “Sistemi po rritet, është financiarisht i përbalueshëm, por në dy vitet e fundit diçka ka ndryshuar.

Të pasurit janë bërë më të pasur dhe të varfrit më të varfër. Bota po ecën në këtë drejtim dhe futbolla nuk bën përjashtim, por futbolla nuk është një industri si të tjerat, është një kompeticion. “Futbolla rritet me 10% çdo vit. Të gjithë janë fiksuar te shifrat që përmenden në lidhje me Nejmar, por të ardhurat e klubeve janë rritur dhe kjo i lejon ata që të shpenzojnë”, deklaroi Traverso.



Nainggolan te Roma deri në vitin 2021

Ragia Nainggolan ka rinovuar zyrtarisht kontratën me Roman. Ai ka nënshkruar deri në 2021. Belgu 29-vjeçar është përfolur për një kalim tek Inter, Çellsa dhe Mançester Junajted. “Roma konfirmon se mesfushori Ragia Nainggolan ka nënshkruar një kontratë të re katërvjeçare me klubin,” shkruhej në faqen zyrtare të klubit. Derisa, pas zyrtarizimit të kontratës së re ka folur edhe vet futbollisti belg. “Mendoj se gjithmonë kam demonstruar se rinovimi ka qenë dëshira ime. Prandaj jam shumë i lumtur që do vazhdoj aventurën time te Roma”, deklaroi Nainggolan. Kujtojmë, Nainggolan iu bashkua Romas në vitin 2014 dhe kontrata e mëparshme skadonte në 2020. “Sezonin e kaluar, ai ishte një nga mesfushorët më të mirë në botë dhe nuk është surprizë që kërkohet nga shumë klube. Por asnjëherë nuk dyshuam se ai do të shkonte diku tjetër” – ai e do Roman dhe Roma e do atë,” deklaruan nga klubi roman.



100 mln euro, ose Belotti qëndron me Torinon

Sulmuesi Andrea Belotti do të qëndrojë në Torino, përveç nëse aktivizohet klauzola e tij e lirimit, tha trajneri Sinisha Mihajloviç. Belotti thuhet se është një objektivi i Milanit pas sezonit të mirë 2016-2017, gjatë të cilit shënoi 26 gola në Seria A. 23-vjeçari është i kontraktuar deri në vitin 2021 dhe ka një klauzolë lirimi prej 100 milion euro, për çdo klub të interesuar nga jashtë. Mihajloviç tha se Belotti, i lidhur më parë me



Mançester Junajted dhe Çellsa, do të qëndronte në Torino, përveç nëse klauzola e tij e largimit do të aktivizohet. “Presidenti Kairo ka qenë i qartë: pagesë e klauzolës, ose asgjë, – tha trajneri serb në një konferencë shtypi. – Vetë jam i kënaqur që ai është me ne. Kemi një marrëdhënie të madhe, besim dhe dashuri”. Belotti u bashkua me Torinon në vitin 2015 dhe ka shënuar 40 gola në 74 ndeshje, në të gjitha garat, për këtë klub.

Bajerni reagon më hapur se kurrë Inter, hiq dorë nga Vidal!



Ka disa javë që spekulohet se Interi do mesfushorin e Bajernit, Arturo Vidal, por kjo nuk ka shans të ndodhë. Klubi italian – edhe pse është një emër i madh dhe i dashur për bavarezët, sepse shefi ekzekutiv i

rekordmenëve, Karl-Heinz Rummenigge, ka një të kaluar zikaltër si futbollist – duhet të heqë dorë nga përpjekjet e veta për të blerë kilianin. “E përjashtoj me 100 për qind siguri largimin e Vidalit. Ai është një lojtar i rëndësishëm për ne, kështu që derën e kemi të mbyllur. Lajmet për interesimin e Interit i kam lexuar vetëm në medie, sepse nuk kam biseduar me ta. Sidoqoftë, asnjë ofertë e tyre nuk ka vlerë. Karlo Anceloti ka folur me të. Kur Bajerni nuk do ta shesë një lojtar, paratë nuk kanë më rëndësi”, – është shprehur Rummenigge. Bajerni ka një marrëdhënie të mirë me Interin, ashtu si edhe me Juventusin apo Real Madridin, kështu që deklarata e drejtuesit bavarez u jep fund spekulimeve dhe ëndrrave të tifozëve zikaltër.

Junajted shpreson në transferimin e Bejll

Gjiganti anglez, Mançester Junajted janë gati të provojnë nënshkrimin e Gareth Bejll këtë afat kalimtar veror. Hoze Murinjo është i etur të forcojë edhe më shumë skuadrën në prag të fillimit të sezonit të ri, ku “Dajtë e Kuq” marrin pjesë edhe në Ligën e Kampionëve. Pas transferimeve të Viktor Lindelof e Romelu Lukaku, “Special One” shpreson që skuadrës t'i shtohet elemente tjera kualitative. Sipas “The Telegraph”, Junajted është në gatishmëri pas dhënies së shpresës për nënshkrimin e Bejll nga Real Madridi. Skuadra e Murinjos mund të jetë në prag të një lëvizjeje të re pasi Zinedin Zidane nuk mundi të garantojë se Bejll do të qëndrojë me klubin këtë verë. Madridi shpreson të nënshkruajë me Kylian Mbappe në një marrëveshje rekord, kështu që njëri nga “BBC” pritet të lirojë vendin.



Roma ka gjetur zëvendësuesin e Kostas Manolas, në rast se ky i fundit largohet nga klubi në këtë afat kalimtar. Sipas "Tuttomercatoweb" ai është mbrojtësi i Atletico Madridit, Josema Himenez

Një ligë e pazakontë

Ligën e futbollit në Afganistan aktualisht e përbëjnë vetëm tetë ekipe. Garat zhvillohen veç në një qytet. Zhvillohen vetëm 18 ndeshje kampionale. Kjo ligë, e krijuar në vitin 2012, ua ka dhënë të rinjve gjënë më të mirë - normalitetin

Hera e fundit kur futbollit afgan tërhoqi vëmendjen e medias botërore ishte për shkak të një djaloshi të ri, idhullit të tij dhe të një qeseje plastike. Lionel Messi takoi djaloshin Murtaza Ahmadi në dhjetor pas një fotografie të djaloshit, në të cilën aty shihej ai që kishte veshur një qese plastike dhe në të kishte vizatuar fanelën e Messit. Kjo fotografi kishte tërhequr vëmendjen në gjithë botën. Pasi Ahmadi ishte lokalizuar në provincën Ghazni në lindje të Afganistanit, djaloshi, i cili ishte refugjat i Kombeve të Bashkuara, u takua me Messin para ndeshjes miqësore të Barcelonës me Al-Ahlin, ndeshje në të cilën Ahmadi kishte qenë maskota zyrtare. Fatkeqësisht, për shkak të kësaj ngjarjeje të famshme familjes së djaloshit i është dashur të largohet në drejtim të Pakistanit, për shkak të frikës së një kidnapi mi të djaloshit, një gjë e cila është mjaft e zakonshme në Afganistan. Ky është njëri prej problemeve më të mëdha në vendin, i cili vazhdon të mbetet i ndarë pas disa dekada konfliktesh.

Por tani ka një shpresë për vendin me një histori problematike e ajo është Premier liga afgane, e cila ka filluar para pesë vjetësh. Kjo ligë përbëhet nga tetë skuadra, sezoni zgjat vetëm tre muaj, nga muaji gusht deri në tetor dhe të gjitha ndeshjet, gjithsej 18, luhen në një qytet të vetëm. Por, ekzistenca e kësaj lige tregon se futbollit mund të sjellë gjëra të mira në situata të vështira. Edhe pse kishte pasur kompe-



tione të tjera para fillimit të kësaj lige në vitin 2012, vit në të cilin NATO-ja kishte larguar trupat nga vendi, ky është kompeticioni i parë profesional në Afganistan dhe përfaqëson një hap të madh për tifozët e futbollit në këtë vend.

Futbolli gjithmonë ka qenë i popullarizuar në Afganistan. Federata Afgane e Futbollit (AFF) ishte hapur në vitin

1933 dhe ishte bërë pjesë e FIFA-s në vitin 1948 (kur edhe luajtën ndeshjen e parë zyrtare në Londër ndaj Luksemburgut, të cilën e humbën me rezultatin 6-0), kurse pjesë e Konfederatës Aziatike të Futbollit u bë në vitin 1954. Nën regjimin taliban prej vitit 1996 deri në vitin 2001 futbollit nuk tolerohej dhe rrallë luhej ndonjë ndeshje. Kishte edhe

dënime brutale, madje edhe ekzekutime publike në stadiume pas pjesës së parë të ndeshjeve. Pavarësisht tentimeve për të kthyer jetën normale në Afganistan, forcat talibane vazhdojnë të mbesin në vend. Kështu që, për shkaqe sigurie ndeshjet zhvillohen në dy stadiumet e kryeqytetit Kabul. Afganistani ka përfituar ekonomikisht nga investimet ndërkombëtare në futboll.

FIFA ka investuar 1.5 milion dollarë që prej vitit 2005 për të përmirësuar infrastrukturën sportive. Investime ka pasur edhe nga Gjermania dhe nga Britania e Madhe. Tetë ekipet e ligës afgane përfaqësojnë tetë regionet kryesore të vendit. Në finalen e vitit të kaluar De Maivand Atalan, klubi nga rajoni jugperëndimor i vendit, i cili mbetet i kontrolluar nga talibanët, luajti kundër Shaheen Asmayees nga Kabul, që konsiderohet "zemra" e qeverisë.

Pavarësisht ndarjeve politike skuadrat arritën të zhvillonin një ndeshje mjaft të mirë, gjë e cila është një shenjë inkurajuese për vendin. Njëri prej themeluesve të kësaj lige, Kris MckDonald thotë: "Futbolli është duke u kthyer në një pasion, sjell kënaqësi dhe lumturi dhe është një gjë të cilën duhet ta vazhdojmë në këtë mënyrë".

"Fair play financiar" po dështon

UEFA përgatit projektin e ri

Çmimet e kripura të merkatos së kësaj vere kanë alarmuar UEFA-n që është vënë në lëvizje për t'u vënë fre klubeve që kanë shpenzuar apo planifikojnë të shpenzojnë shumë marramendëse. "Fair play financiar" është një mekanizëm i ngritur nga ky institucion pikërisht për të ndaluar çmendurinë e merkatos por rregullat mund të ndryshojnë, pasi mesa duket, edhe ky mekanizëm po dështon duke parë rastet e fundit të merkatos së Mançester Sitit apo edhe projektin e PSZH për Nejmar. Sistemi aktual i aplikuar në vitin 2011 synon rregullin e bilanceve të skuadrave që kualifikohen në kupat evropiane. Gjithçka bazohet në principin "shpenzon sa arkëton", pa borxhe me klube apo persona të tjerë. Logaritë bëhen në fund të çdo



3-vjeçari dhe cikli aktual që mbyllet në vitin 2018 lejon deri në 30 milionë euro deficit por edhe këto në rastet kur justifikohen me shpenzimet për ekipet e grupmoshave. Klubet që nuk respektojnë limitin e shpenzimeve mund të skuatifikohen nga UEFA por i nënshtrohet edhe masave të tjera si gjoba dhe kufizime në merkato deri në momentin që

bilanci financiar do të rikthehet në normalitet. Gjithsesi, pas 6 vitesh, UEFA e ka kuptuar se modeli "Fair play financiar" kërkon modifikime të shumta. Presidenti Çeferin është njeriu kryesor që po ndërmerr disa iniciativa për të kufizuar shpenzimet e mëdha. Një ide është taksa e luksit që bazohet në vlerën e shitjes dhe të pagës së lojtarëve. Shembull;

Nëse një klub blen Messin për 100 milionë, atëherë duhet të paguajë 10 deri në 100 për qind të vlerës për sistemin. I njëjti diskutim është edhe për pagën. Shumat që do të grumbullohen, do t'u shpërndahen klubeve në nevojë në liga të ndryshme evropiane por kjo formulë nuk është përcaktuar ende. "Tavani i pagës" është një tjetër pikë e rëndësishme e projektit të ri që nuk do të lejojë që një klub të kalojë tavanin e shpenzimeve për pagat e lojtarëve. Reduktimi i organikave është pika e fundit që synon të vendosë limitin e numrit të lojtarëve që mund të transferojë një skuadër gjatë dritares së merkatos, por edhe rregullimin e formulave të huazimit pasi në shumë raste huazimi i lojtarëve mbi 30 vjeç nuk ka logjikë.

Shkurt

Iturbe largohet nga Roma

Gjithmonë i jepen raste, por asnjëherë nuk i shfrytëzon ato. Fjala është për sulmuesin argjentinas, Huan Manuel Iturbe i cili duket se përfundimisht do të largohet nga Roma. Sulmuesi argjentinas nuk e ka bindur as trajnerin e ri Eusebio Di Françesko me paraqitjet e tij të dobëta në turneun e Amerikës. Kjo ka bërë që Roma të kërkojë nga lojtari largimin dhe ai është afër transferimit në Gjermani. Borussia Menhegladbach ka kërkuar huazimin e lojtarit me të drejtë blerje për 11 milionë euro. Ndërkohë Roma e ka refuzuar ofertën e parë të Gladbahut pasi kërkon që blerja të jetë e detyrueshme. Interesim për lojtarin ka shprehur edhe Kruz Azul dhe Boka Juniors.

Perez afër transferimit në Bajër

Lukas Perez do të largohet nga Arsenalin dhe këtë e ka konfirmuar vetë lojtari. Spanjoli ka bërë të qartë se është i hidhëruar me klubin pasi ata nuk kanë shfaqur respektin e tij ndaj tij. Së fundmi në garë për transferimin e tij është futur edhe skuadra gjermane Bajër Leverkusen. Gjermanët kanë gati 12 milionë euro për transferimin e spanjollit në Bundesliga. Gjithsesi dëshira e Perez mbetet të rikthehet në La Liga, ku po e pret ish-skuadra e tij Deportivo La Korunja. Perez ka kontratë me Arsenalin deri në vitin 2020.

PSZH futet në garë për Pereiran

Parist Sen Zhermen nuk po mendon vetëm për transferimin e brazilianit Nejmar. Gjiganti francez është futur në garë për transferimin e mesfushorit portugez, Danilo Pereira. E përditshmja franceze "L'Equipe" ka shkruar se PSZH ka bërë ofertë prej 50 milionë euro për mesfushorin. Anëtar i Portos ka shkëlqyer me fanelën bardh e kaltër dhe është bërë i rëndësishëm edhe tek Kombëtarja portugeze. Kësisoj e ardhmja e tij duket larg Portos, pasi klubi portugez thuhet se është dorëzuar dhe do ta lejojë largimin e tij. Pereira pritet të nënshkruajë kontratë pesë vjeçare me klubin nga kryeqyteti francez. Për reprezentuesin portugez interesim kishte shprehur edhe skuadra angleze Arsenal.

Lacio afër goditjes së madhe

Skuadra italiane Lacios nuk po qëndron duarkryq pasi po synon përfundimin e ekipit për stinorin e ri. Kryeqytetasit do të luajnë në Ligën e Evropës, ndërsa synojnë që të shkojnë sa më lartë në këtë garë. Emri i madh që pritet ta përforcojë ekipin është ai i mesfushorit algerian, Jasin Brahimi. Sulmuesi anësorë i Portos ka pasur një vit jo edhe aq të mirë, por mbetet ndër më të vlerësuarit në Evropë. Për 27-vjeçar, drejtori sportiv i Lacios, Iglu Tare ka gati një ofertë katër vjeçare me tre milionë euro pagë vjetore. Ndërkohë, Lacio po tenton ta bind Porton me 23 milionë euro që ta lënë të lirë yllin tyre.


Dortmundi huazon Emre Mor

Emre Mor pritet të largohet nga Borussia Dortmund. Hapësirat jo të mëdha kanë bërë që reprezentuesi turk të kërkojë një skuadër që i garanton minutazhë më të madhe. 20-vjeçari pritet të huazohet nga verdhezinjtë për një stinor që të ketë hapësira më të mëdha. Wolfsburg dhe Hannover janë dy skuadrat në Gjermani që kërkojnë shërbimet e talentit shtatshkurtër. Ndërkohë Selta Vigo e dëshiron në La Liga dhe Fenerbahçe në Superligën e Turqisë. Huazimi i tij pritet të bëhet gjatë fillimit të javës së ardhshme, ndërsa favoriti mbetet Wolfsburg.


Medel refuzon Turqinë për Bokan

Gary Medel i Interit raportohet se ka refuzuar klubin turk Trabzonspor sepse dëshiron rikthimin te Boka Juniors. Kiliani ka kontratë deri në qershor të vitit të ardhshëm, por nuk është në planet e trajnerit Luçiano Spaleti. Sipas "Radio Continental", Medel ka refuzuar Trabzonsporin sepse ëndërron të rikthehet te klubi i vjetër nga i cili u largua më 2011.


DASHI (20/III-20/IV)

 Yjet sot nuk mund t'ju favorizojnë. Marrëdhëniet bashkëshortore, familjare dhe ato shoqërore do të jenë të tensionuara. Mundohuni mos merrni vendime të rëndësishme sot, por prisni deri të enjten ku gjithçka do të kthehet si më parë.


DEMI (21/IV-20/V)

 Hëna dhe Saturni ju mbështesin, kështu që nuk do të hasni asnjë vështirësi, por do të përballoni gjithçka duke pasur besim te vetvetja. Në sektorin e ndjenjave do të ndjeheni entuziast dhe do të kenë një dialog të hapur me partnerin.


BINJAKËT (21/V-20/VI)

 Sot nuk do të tregoheni aspak diplomatik dhe kjo rrezikon t'ju prish disa situata të favorshme në sektorin profesional dhe sentimental. Mundohuni të respektoni afatet që ju janë kërkuar në punë dhe tregohuni më tolerant me familjarët tuaj.


GAFORRIA (21/VI-22/VII)

 Dikush mund të luaj një lojë aspak të ndershme karshi jush, tregohuni vigilent që të kemi gjithçka nën kontroll, sidomos në qoftë se bëhet fjalë për interesa të tipit financiar. Mos përzieni ndjenjat me çështje interes, është një rregull i vjetër që harrohet.


LUANI (23/VII-22/VIII)

 Në punë mund t'ju paraqiten të reja interesante që deri dje dukeshin të pamundura. Kini kujdes me sinjalet që ju dërgojnë yjet, mos humbisni okazionet e mira. Një mbrëmje e organizuar nga miqtë tuaj do ju kënaq pa masë.


VIRGJËRESHA (23/VIII-22/IX)

 Dita e martë për ju do të jetë ideale për të qëndruar në shoqërinë e miqve dhe personave që ju qëndrojnë pranë. Do të shprehni pa u rezervuar anë të mira të personalitetit tuaj. Momente romantike për ata që janë çift, ndërsa ata që janë singël do të arrijnë suksese sentimentale.


PESHORJA (23/IX-22/X)

 Ecn para në rrugën që keni nisur pa hezituar sepse Hëna parashikon një sërë prespektivash për ju. Klima çlodhëse që ofron vera favorizon aventurat sentimentale për ata që janë singël dhe më të rinjtë e kësaj shenje.


AKREPI (22/X-21/XII)

 Duhet të tregoheni më të aftë në drejtimin e një çështje financiare. Me partnerin do të realizoni një marrëdhënie të kënaqshme edhe nga pikëpamja erotike. Një miku juaj mund t'ju kërkoj para borxh.


SHIGJETARI (22/XI-21/XII)

 Dita e sotme nuk do të jetë dhe aq e lehtë dhe kjo si shkak i disa pozicioneve negative yjore. Në qoftë se dëshironi të shmangni kritikën në ambientin e punës tregohuni më të përpiktë dhe organizues.


BRICJAPI (22/XII-20/I)


 Si shkak i përplasjes midis Hënës, Marsit dhe Jupiterit mund të shfaqet xhelozia, si në marrëdhëniet në çift, ashtu edhe në bashkëpunimet profesionale. Një miku juaj do ju ndihmojë të kaloni këtë periudhë.

UJORI (20/I-19/II)

 Do të jetë më mirë për ju të qëndroni neutral dhe objektiv në një situatë profesionale akoma të pa përfunduar. Hëna dhe Jupiteri, në kundërshtim me shenjë tuaj ju bën të shpenzoni më shumë seç duhet.

PESHQIT (20/II-19/III)

 Falë Diellit dhe Hënës, sot gjithçka do të funksionojë më së miri. Hëna do të stimulojë fantazinë dhe shpirtin tuaj krijues. Keni aftësi të jashtëzakonshme për të manipuluar situata të ndryshme duke i kthyer në favorin tuaj. Mbrëmje e shkëlqyer për ata që po jetojnë një histori të re dashurie.

Koha Koha	VEPROJ ME KUJDES	EGËR, ME EGËRSI	VEGËL (NGRITJEN E AUTOMJET.)	RËNTGEN	QYTET NË MAQEDONI	KAÇAK LEGJENDAR ANGLEZ	euz.com				
MATERIAL NDËRTIMOR ARTIFICIAL I NGJASHËM ME BETONIN						AKTORI, NOLT					
KRYEQYTETI I KROACISË AI QË MERRRET ME KRITIKË											
ZATET, HAS						AKTORI ANGLEZ, EROL					
QYTET ANTIK NË AZI TË VOGËL			VERY HIGH FREQUENCY RADIO LOKATOR								
ZET PAGESA MUJORE E NJË PUNONJËSI		FUTBOLLIST I REAL MADRIDIT GOJA - GOJËS									
				KAM NJOHURI IRIDIUM			VËLLA I MADH	QË LIDHET ME KRIME A ME KUNDËR- VAJTJE	KOMPANI TELEVIZIVE AMERIKANE	AKTORJA ITALIANE, MASARI	METËR, TON
ELEMENT KIMIK (J)					BOMBË FLAKË- HEDHËSE AKTORI, ROBERT						
Koha Koha	NJËSI MATËSE BRITANIKE PËR GJATËSI POEZIA E DASHURISË					FOSHNJAT ARMË NËNUJORE (shq.)					
QYTET NË SUEDI				THELBI, QENËSIA SIMBOL I JETËS (mit.egjipt.)							PASUES I NJË HEREZIE
ROD STJUART				MJET LUNDRIMI (shq.) BANOR I OMANIT					PAJTIM, PARAPAGIM	HIDROGJEN BARAS	
ZERO		BASKETB. AMERIKAN, SHEKIL QYTET NË JAPONI					E LABËRISË OSE E LABËVE ADET				
AKTORI AMERIKAN NGA FOTO							ILAÇ MËZAT (spanj.)				
PATRIOTI YNË, BOLETINI				GOJËTARE KANAL TV SHTETËROR TURK							
FILOZOFI GJERMAN, EMANUEL					PIKTURAT KISHTARE FLORI						
						USHQIMI KRYESOR I KINEZËVE OKSIGJEN					
RROTKË PENJËSH	I ASTRONO- MISË										

FJALËKRYQ KLASIK

1	2	3	4	5	6	7	8	9
10				11				
12			13					
14			15					
		16					17	
18	19					20		
21					22			
23								

HORIZONTALISHT:

1. Mjeshtëria luftarake; 10. Element radioaktiv (U); 11. Rizoto; 12. Aktori amerikan, Aflek; 13. Shtëpi banimi; 14. Siboli kimik i Jodit dhe Azotit; 15. Latues; 16. Murg endacak mysliman; 17. Kirk Daglas; 18. Govata; 20. Monedhë e vjetër hinduse; 21. E trakisë; 22. Njëra prej figurave me vlerë në lojën me letra; 23. Biseda për shtyp apo televizion.

VERTIKALISHT:

1. Kryefjala (gjuh.); 2. Mjet udhëtimi e transporti; 3. Ish futbollisti gjerman, Uve; 4. Kyç; 5. Amulli shpirtërore, pandjesia; 6. Që ka të bëjë me gjininë, i gjinisë; 7. Lumë në Hungari; 8. I marr dikujt masën e trupit; 9. Hyjnesha e dashurisë (mit.greke.); 13. Mikrob; 15. Jo fetare; 16. Murg françeskan; 17. Filozofi gjerman, Emanuel; 19. Lumë në Francë; 20. Prapa; 22. Shkronjë greke.

ZGJIDHJET: R, TEKTON, ZAGREBI, KRITIK, TAKON, IS, VHF, Z, RAUL, RROGA, DI, JODI, NAPALM, JARD, BEBET, FAR, ESENCA, RS, ANIJA, H, O, ONIL, LUBE, TOM KRUZ, BAR, ISA, ORATORE, KANT, IKONAT, MAKARA, ORIZI, ASTRONOMIK, FJALËKR, KLASIK, STRATAGJEMA, URAN, PILAF, BEN, BANESË, JN, LATOR, R, E, FAKIR, KD, KORITA, PAI, TRAKE, FANT, INTERVISTA.

7 arsye të mëdha për të ngrënë fiq sa më shpesh

Fiku, fruta e parajsës e cila ripërtërin, forcon, e ruan shëndetin dhe fshin rrudhat. Një bimë që jep shumë ndërsa i nevojitet pak, vetëm tokë e varfër dhe ndonjë pikë e ujit, konsiderohet ushqim i njohur për vetitë shëruese.

1. Përmbajtje e lartë e magnezit. Magnezi është një nga elementet bazë që e mbron sistemin tonë nervor nga stresi. Ai është shumë i rëndësishëm për eshtrat, imunitetin dhe shëndetin e trurit. E promovon shëndetin dhe vitalitetin, shëron shumë sëmundje, dhe në mënyrë të konsiderueshme e ngadalëson procesin e plakjes. Fiqtë e thatë përmbajnë tri herë më shumë magnez se ata të freskët.

2. Është i pasur me kalium, kalcium, hekur, fosfor, bakër, dhe vitamina B6, C, si dhe beta-karotinë. Përmbajtja shumë e ulët e yndyrave dhe përmbajtja më e lartë e fibrave se cilado pemë dhe perime tjetër është një



nga arsyet se pse fiku do të duhej të konsumohet çdo ditë, transmeton Koha.net. Pektina është një fibër e tretshme e cila e ul kolesterolin në gjak, ndërsa triptofani ndihmon me problemet e qarkullimit të gjakut dhe pagjumësisë.

3. Përqindja e lartë e sheqernave natyrorë do të sigurojë që truri juaj të punojë më shpejt dhe t'i pranojë dhe klasifikojë më mirë informacionet. Sigurisht, diabetikët duhet të kenë kujdes gjatë ngrënies së fiqve të thatë të cilët përmbajnë dy herë më shumë sheqer se ata të freskët.

4. Fiqtë e thatë janë një burim i shkëlqyer i shumë ushqyesve dhe gjithashtu një vakt praktik dhe i vlefshëm për atletët rekreativë dhe profesionistë, ndërsa në kombinim me produktet e arrave mund të shërbejë si një meze ideale. Çaji i fikut i shëron sëmundjet e mëlçisë, fytit, organeve të frymëmarrjes, gurët e tëmthit, fshikëzës.

5. Përmbajnë edhe sterole bimore, për të cilat është dëshmuar se kanë efekt të dobishëm në nivelin e kolesterolit në gjak. Sterolet bimore si lanosteroli dhe stigmasteroli, të cilat i përmbajnë

fiqtë lidhen për molekulat e kolesterolit në zorrë dhe kështu e pengojnë absorbimin e tij.

6. Studimet e shumta kanë zbuluar komponime me efekte të mundshme antikancerogjene, benzaldehid dhe kumarinë, me të cilat fiku është i pasur. Komponimet e testuara në studimet shkencore kanë treguar rezultate premtuese sidomos kur bëhet fjalë për kancerin e prostatës dhe të lëkurës.

7. Fiku i freskët përmban deri në 80 përqind ujë dhe 60 përqind sheqer natyror, kështu që dobia e konsumimit të fikut është e shumëfishtë ashtu si edhe mënyrat e konsumimit, transmeton Koha.net. Shija e ëmbël e fikut përshtatet në mënyrë të përkryer me shijet e kripura, si djathi i deles apo dhisë, atë mund t'ia shtojmë kompostove të ndryshme apo gjellëve me përbërje të pulës. Nga fiku i freskët mund të bëjmë komposto, reçel dhe pije të fermentuara.

Kërcënime nga Rusia, Era Istrefi anulon pjesëmarrjen në festivalin e Moskës

Në festivalin "Europa Plus", i cili do të nisë sot në Moskë, pritej të performonin "live" katër këngëtare shqiptare, ku përveç Bebe Rexhës, Dua Lipës e Arilena Arës do të ishte edhe Era Istrefi. Megjithatë, në momentet e fundit, "Indeksonline" shkruan se Era ka anuluar pjesëmarrjen e saj në këtë festival. Shkak për këtë anulim duket se është bërë siguria. Perfor-



mancat në gjuhën shqipe dhe prezantimi si shte-

tase nga Kosova, mësohet se kanë nxitur kërcënime ndaj këngëtares dhe autoritetet e sigurisë kanë rekomanduar që Era të mos udhëtojë drejt Moskës. Tashmë në këtë festival të muzikës do të performojnë vetëm Bebe Rexha, Dua Lipa dhe Arilena Ara. Era Istrefi është duke punuar në projektin e ri të saj, i cili publikohet më 25 gusht në bashkëpunim me superyllin e hip hopit, French Montana.

Festivali i gjarpërinjve

Festivali i gjarpërinjve ka tërhequr me mijëra besimtarë hindu në shtetin verior indian të Uttar Pradesh-it. Njerëzit vërshojnë nëpër tempuj për t'u lutur e për të ofruar dhuratat e tyre gjatë festës së kremtuar përvit në ditën e pestë të dy javorëshit që paraprind hënën e plotë të muajit hindu të "Shravanit" apo musonit. Të devotshmit lënë lule, qumësht, ose gjethe të pemës vendase të bilvës, të konsideruara si simboli mashkullor i fuqive të ripërterira të lordin "Shiva", hyj i trans-

formimit. Në besimin hindu, "Shiva" paraqitet me një gjarpër të rrotulluar rreth fytit. Rritësit e këtyre zvarranikëve u ulën përpara tempujve, ndërsa besimtarët janë vënë në radhë për t'i ofruar qumësht e për të kërkuar bekimin e tyre. Këta njerëz besojnë se një personi i përmbushën dëshirat nëse i ofron gjarpërit qumësht. "Sot është dita e hyjit të gjarpërinjve, një ditë që në e njohim si "Nag Panchami". Kjo është arsyeja përse të devotshmit i dhurojnë gjarpërinjve qumësht e



gjëra të tjera. "Ata luten që e keqja të zhduket nga jetët e tyre dhe që bekimet e zotit të gjarpërinjve t'i shoqërojnë gjithmonë", thotë Kundan Pandey, klerik hindu. Budizmi gjithashtu e vesh

gjarpërin me cilësi të larta hyjnore. Besohet se një kobra shpëtoi jetën e Budës dhe një tjetër mbrojti figurën qendrore të rrymës fetare indiane të Jainismit, Jain Tirthankara.

Mercedes tërheq tre milionë makina nga tregu european

Prodhuesi gjerman Mercedes, ka njoftuar se do të kthejë prapa tre milionë makina me naftë që janë shitur në Evropë, për shkak të ndotjes së lartë. Gjatë muajit mars, ishin kërkuar të tërhiqen 250 mijë makina për të njëjtin problem, që ishin kryesisht nga modeli V-Class, transmeton "Telegrafi". Mirëpo, duke



pasur parasysh se jo të gjitha po i përshtaten


normave Euro 5 dhe Euro 6, është konsideru-

ar kthimi gjigand i veturave, që do të fillojë javëve që vijnë. Ky rast e dëmton kompaninë Mercedes me 220 milionë euro, ndërsa klientët do të kompensohen dhe nuk detyrohen të paguajnë asgjë. Inxhinierët janë duke u angazhuar në krijimin e motorëve specialë, që lëshojnë shumë pak ndotje.

KALENDARI HISTORIK 29 KORRIK

- 1014 – Beteja e Strumicës: Bizanti shkatërron ushtrinë Bullgare.
- 1565 – Meri, mbretëresha e skocezëve martohet me kushëririn e saj, Henri Stjuard.
- 1579 – Mbreti Filipi II arreston komplotistët Antnio Perez dhe princeshën van Eboli.
- 1588 – Sulmuesja Armada Spanjolle mundet dhe shkatërrohet nga mbrojtësit anglez.
- 1693 – Beteja e Nirvindenit: Francezët mundin armatën angleze-holandeze.
- 1783 – Vullkani Skaptar në Islandë shpërthen duke mbytur 9000 persona.
- 1836 – Inaugurimi i Arc de Triomphe në Paris.
- 1858 – Nënshkruhet Traktati i parë komercial mes SHBA dhe Japonisë.
- 1913 – Shpallet sovraniteti i Shqipërisë nën Princin Uilhem von Vid.
- 1914 – Austro-Hungaria bombardon Beogradin.
- 1923 – Albert Ainshtajni felt për pacifizmin në Berlin.
- 1937 – Trupat japoneze okupojnë Pekinin.
- 1961 – Bob Dilan lëndohet në aksident me makinë.

A E DINI SE...



Krokodili nuk mund të lëvizë gjuhën e vet.

Një njeri mesatar kalon 25 vjet të jetës në gjumë.



Një vit ka 31,557,600 sekonda.

BARSOLETA



VAJZA E PISPILLOSME

Vajza u vesh u pispillos..

Babi : ku po iken moj bije tani ne gjysme te nates..?

Vajza : ne banjo babi me duhet urgjentisht nje foto e re profili.

NË PAZAR

Një hajdut shkon në Pazar për të shitur rrobat që kishte vjedhur, por një hajdut tjetër ia vjedh.

Në darkë e shoqja e cila e sheh të mërzitur e pyet: "Sfitove gjë?"

– Hajduti duke qeshur: "–Kësaj here i shita me çmimin që i mora.

THËNIA E DITËS

Ne e pranojmë dashurinë që mendojmë se e meritojmë

Stephen Chbosky

